



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim i Përputhshmërisë)

“MINISTRI I SHTETIT
PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES”

Janar, 2023



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim i Përputhshmërisë)

“MINISTRI I SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES“

<u>Nr.</u>	<u>Përmbajtja</u>	<u>Faqe</u>
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3-5
	OPINIONI I AUDITIMIT	5-6
II	HYRJA	6-12
	1. Objektivat dhe qëllimi.....	
	2. Identifikimi i çështjes.....	
	3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	
	4. Përgjegjësitë e audituesve.....	
	5. Kriteret e vlerësimit.....	
	6. Standardet e auditimit.....	
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13-55
	<i>1. Auditimi për krijimin dhe funksionimin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për periudhën objekt auditimi. Auditimi mbi shqyrtimin dhe ndjekjen e ankesave administrative të sipërmarrjes private, përfshirë dhe ato të investitorëve strategjikë dhe /ose të huaj, kundrejt institucioneve publike.</i>	13-29
	<i>2. Auditimi mbi mbështetjen për zhvillimin dhe monitorimin e startup-eve dhe ekosistemit në zbatim të ligjit nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”. Këshilli i Startup-eve në nxitjen e zhvillimit të startup-eve si organ kolegjal.</i>	30-31
	<i>3. Auditimi mbi procedurën e thirrjes për aplikime për përfitimin e granteve nga ana e startup-eve dhe lehtësuesit e startup-eve nëpërmjet publikimit në shërbimin startup one-stop-shop në faqen zyrtare. Komisioni i vlerësimit në shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve të mbërritura për startup-et.</i>	31- 55
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET.SIPAS DREJTIMEVE TE ANGAZHIMIT.	55-64



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.

1.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Referuar përcaktimeve të nenit 3 dhe 4, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, “Ministri i Shtetit dhe kabineti i tij, janë në strukturë dhe përbërje të Kryeministrisë, e cila është person juridik, publik, që mbështet veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe të Ministrit të Shtetit”.

Sipas përcaktimeve në dokumentet e politikave si dhe në VKM nr.511, datë 13.09.2017 dhe nr. 610, datë 20.10.2021, misioni i Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është të ndihmojë dhe të mbrojë sipërmarrjen private, që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, si dhe të promovojë bashkëpunimin ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes e përmbush misionin e ndërmarrë nëpërmjet shqyrtimit, ndjekjes dhe trajtimit të ankesave administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të cilat përfshijnë institucionet publike të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike si dhe të zyrtarëve të tyre. Një ndër detyrat e rëndësishme të këtij Institucioni është dhe përpunimi dhe propozimi i përmirësimeve të nevojshme funksionale, për platformën elektronike të ndërveprimit me sipërmarrjen për komunikimin dhe gjurmimin e ankesave të tyre, si dhe për regjistrin e komunikimit të brendshëm të trajtimit të ankesave, përmes të cilit monitoron procesin ndërinstitucional.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit nr. 792/2 prot, datë 19.09..2022, në institucionin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Tiranë, nga data 09.09.2022 – 31.10.2022, për periudhën nga 01.01.2017 deri në 30.06.2022. Në fokusin e angazhimit janë kryerja nga ana e këtij institucionit në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi nënligjore në fuqi në fushën e mbrojtjes dhe shqyrtimit të ankesave , krahas mbështetjes së sipërmarrjes, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar, mbi menaxhimin financiar, kontrollit dhe qeverisjes, etj.

1.2. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi.

GJETJ A NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	REFERE NCA ME RPA	RËNDË SIA	REKOMANDIMI
I.	Gjatë periudhës objekt auditimi rezultojn se, fusha e përgjegjësisë dhe e kompetencave të këtij institucioni publik, (miratuar me VKM nr. 511, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, shfuqizuar nga VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”), ka elementë të mbivendosjes së tyre me ato të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, institucion i krijuar nga Ligji Nr.107/2021, datë 4.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”. Rezultojn se, ky ndryshim i fushëveprimit, përgjegjësisë dhe kompetencave të MiSHMS, nuk është reflektuar me përmirësimet e nevojshme të VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”.	Më hollësisht trajtuar në pikën nr1. të Raportit të Auditimit	L	Për të evituar përplasjet e mundshme të kompetencave dhe të fushës së përgjegjësisë zyrtare, me qëllim qartësimin e objektit të veprimtarisë, institucioni i Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në bashkëpunimin me Kryeministrinë, të marrë masat për hartimin dhe propozimin e përmirësimeve të nevojshme të kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke ngritur një grup pune për rishikimin dhe ridimensionimin e fushës së veprimtarisë, për të paraqitur sa më drejtë rolin, misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit, përmes ndryshimeve në VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”.
II.	Gjatë auditimit u konstatua se MiSHMS është njëkohësisht dhe Kryetar i Këshillit të startup-eve dhe Kryetar i Komisionit të vlerësimit të dhënies së granteve për mbështetje e startup-eve. Kështu sipas përcaktimeve të Pikës 2, Nëniti 8 të Ligjit nr. 25, datë 10.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” Ministri i Shtetit të Mbrojtjes së Sipërmarrjes është Kryetar i Këshillit të	Më hollësisht trajtuar në pikën nr3. të Raportit të Auditimit	L	Të merren masat nga ana e Ministrit të Shtetit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes, që, të bëhen propozimet për përmirësimet e nevojshme të kuadrit ligjor në fuqi, përkatësisht të, pikës 4, të Nenit 14 “Mbështetja e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse”, të Ligjit nr. 25, datë 25.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, si dhe



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	<p>Startup-eve, si dhe sipas përcaktimeve të Pikës 4, Neni 14 të po këtij ligji Ministri i Shtetit të Mbrojtjes së Sipërmarrjes është dhe Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të dhënies së granteve për mbështetjen e startup-eve. Këshillit i startup-eve si organ kolegjal ka kompetenca si dhënies e kontributit për politikat ekzistuese në nxitjen e zhvillimit të startup-eve dhe ekosistemit, ndërsa Komisioni i Vlerësimit të dhënies së granteve për mbështetjen e startup-eve është organ vlerësues për kërkesat e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve përgjatë procesit konkurrues. Detyra e kryesimit të Komisionit të vlerësimit sipas kompetencave të përcaktuara në Pikën 13, Kreu IV të VKM 313, datë 11.5.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishe për përbërjen e Komisionit të vlerësimit, si dhe të kriterëve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij” përbën një funksion administrativ. Përbushja e detyrës së vlerësimit të fituesve apo jo fituesve pas një procesi konkurrues nga Ministri cenon linjën e raportimit të procesit të vlerësimit të projekteve inovative. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me Ligjin 90/ 2012 “Për funksionimin e administratës shtetërore”, Seksioni 1 Ministrisë, Neni 11 “Struktura e ministrisë”, Pika 1 dhe Ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II përgjegjshmëria menaxheriale” Neni 8 Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit Pika 1, Pika 8/a dhe d.</p>			<p>pikës 3, të Kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 315, datë 11.05.2022,</p>
III.	<p>Institucioni i MiSHMS për periudhën 10.09.2017 deri më 30.6.2022 ka funksionuar pa një rregullore të brendshme të miratuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, nenit 29, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe nenit 8” Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika nr.1 dhe nr.8, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</p> <p>Strategjia për Ndërveprim mes Sipërmarrjes dhe Institucioneve Publike është dokument i përgatitur nga ana e MiSHMS në vitin 2018, por që nuk i është nënshtruar rishikimit çdo 3 vjet, në përputhje me kërkesat e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik.</p>	<p>Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3. të Raportit të Auditimit</p>	L	<p>Nga ana e institucionit të MiSHMS, të merren masat për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të institucionit, në përputhje me detyrimet që rrjedhin sipas pikës nr. 4/b, të VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të MiSHMS”, duke përcaktuar rregullat lidhur me organizimin, funksionimin e brendshëm dhe veprimtarinë e MiSHMS, detyrat funksionale të përgjithshme dhe të veçanta të Kabinetit, metodat e brendshme të punës dhe mbarëvajtjen dhe disiplinën në marrëdhëniet e punës dhe etikën profesionale të stafit, procedurat e komunikimit ndërmjet tyre dhe Koordinatorit përkatës në Zyrën e Bashkëqeverisjes, etj. Dokumenti i rregullores së brendshme duhet të pasqyrojë rolin e MiSHMS në kuadër të Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar”, funksione dhe veprimtari që kanë si bazë Ligjin nr.57/2014 “Për Këshillin Ekonomik Kombëtar” të ndryshuar, si dhe VKM nr..281, datë 16.5.2018.</p>
IV.	<p>Në institucionin e MiSHMS për periudhën objekt auditimi nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurma auditimit për proceset kryesore, në kundërshtim me përcaktime e pikës nr.4, të VKM nr. 511, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë së ministrit të shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes”, nenit 4, pika 19, si dhe nenit 16, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010,</p>	<p>Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3. të Raportit të Auditimit</p>	L	<p>Të merren masat nga ana e institucionit të MiSHMS, për përgatitjen dhe miratimin e gjurmës së auditimit të proceseve kryesore (të tilla si, skema e përfitimit / financimi i granteve për thirrjet e startupeve dhe lehtësuesve, promovimin e sipërmarrjes, ndjekjen e ankesave të subjekteve të biznesit me statusin në “Proces Verifikimi “që janë brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të MiSHMS, koordinimin me hallkat e tjera të administratës dhe rolin në kuadër të sekretariatit të KEK, etj.</p>
V.	<p>Nga ana e MiSHMS të merren masat për hartimin dhe depozitimin tek nëpunësi i parë autorizues, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit pasardhës, të Pyetësorit të Vetëvlerësimit, Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshme të kësaj njësie publike, për vitin e mëparshëm.</p>	<p>Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 1 të Raportit të Auditimit</p>	L	<p>Nga ana e MiSHMS të merren masat për hartimin dhe depozitimin tek nëpunësi i parë autorizues, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit pasardhës, të Pyetësorit të Vetëvlerësimit, Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshme të kësaj njësie publike, për vitin e mëparshëm.</p>
VI.	<p>Megjithëse sipas përcaktimit në Pikën 3, Neni 14 të Ligjit 25/2022 thirrjet për grant do të hapen sipas prioritete të përgjithshme që duhet të plotësojnë projektet konkurruese, gjatë auditimit nuk u konstatua shpallja e thirrjes së parë të mbështetjes me grant sipas një prioriteti specifik. Veprimi i mësipërm sjell riskun e krijimit të një procesi të pa adresuar të mbështetjes me grant.</p>	<p>Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3. të Raportit të Auditimit</p>	L	<p>Në kuadër të rishikimit të strategjisë MiSHMS të marrë masa mbi hartimin dhe reflektimin e një plani në lidhje me prioritetin përkatës së çdo thirrjeje për grant në funksion të krijimit të një procesi të adresuar të mbështetjes me grant</p>
VII.	<p>Rregullorja e grantit nuk është e emërtuar si një rregullore specifike për thirrjen e parë megjithëse në afatet e thirrjes rezultojn të përfshijë vetëm vitin 2022 apo nuk përmban një tabelë kohore me afate të standardizuara e gjithëpërfshirëse, të vlefshme për të gjitha thirrjet e mundshme për grant.</p> <p>7.1. Megjithëse vlefshmëria, shpallja e fituesve dhe lidhja e kontratave të thirrjes së parë për grant janë shpallur në përbushje të Rregullores “Për përcaktimin e rregullave të hollësishe për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve që aplikojnë për masa mbështetëse”, gjatë auditimit konstatohet se datat e tyre kanë qenë subjekt i vazhdueshëm i ndryshimit, pas njoftimeve përkatëse në faqen zyrtare të MiSHMS,</p>	<p>Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3. të Raportit të Auditimit</p>	L	<p>Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të vlerësojë dhe marrë masat për përmirësimin e dokumentit të “Rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishe për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve që aplikojnë për masa mbështetëse”, miratuar me urdhrin nr.3, datë 16.5.2022 të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, pasi në rregulloren e grantit:</p> <ol style="list-style-type: none">Mungojnë filtrat e kontrollit paraprak të vlerësimit të dosjeve të çdo aplikanti për mbështetje me grante buxhetore, para shqyrtimit nga Komisioni i Vlerësimit;Nuk jepet asnjë detaj mbi mënyrën e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe sekretimit të vlerësimeve të kryera nga ana e çdo anëtarë,Mungon përcaktimi nga ana e çdo anëtarë të Komisionit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

<p>konkretisht me Njoftimin e MiSHMS Nr. 3223, datë 03.06.2022 dhe Njoftimin Nr. 3697, datë 27.06.2022 “Njoftim mbi shtyrjen e shpalljes së fituesve.</p> <p>7.2. Në përbërje të procesverbaleve të komisionit, që përkojnë me vendimet konkrete të fituese dhe jo fituese nuk ka një relacion shpjegues si është deduktuar vlerësimi si fitues mbi 80 pikë. Ky vlerësim nuk është bazuar në rregulloren e grantit, pasi nuk ka një parashikim në të. Në rregulloren e grantit Pjesa X. Procedura e monitorimit të projekteve fituese është cilësuar se: “Fituesit do të shpallen sipas renditjes së pikëve të mbledhura, në raport me fondin total në dispozicion.”</p> <p>7.3. Gjithashtu në rregullore nuk ka një parashikim mbi një përqindje apo shumë kundrejt totalit të parashikuar për tu shpërndarë në këtë thirrje midis dy kategorive startup apo lehtësues, megjithëse konstatohet se më shumë se 50%, (konkretisht 56%) të shumës së fondit të miratuar për tu shpërndarë i përket pikërisht kategorisë së lehtësuesve (dhe vetëm 44% i përket kategorisë së startup-eve). Nga auditimi i procesit, që prej krijimit të pasaportës së aplikuesit deri në vendimin e Komisionit të Vlerësimit në lidhje me listën e fituesve dhe jo fituese u konstatua se janë miratuar fonde në dispozicion për startup-e në shumën 83,021,375 lekë ose 32% kundrejt shumës totale të miratuar dhe janë miratuar fonde në dispozicion të lehtësuesve në shumën 177,917,073 lekë ose 68% kundrejt totalit të fondeve totale të miratuara, konkretisht 260,938,448 lekë. Numri i aplikimeve fituese për startup-e përbëjnë 5% të totalit të aplikimeve për startup dhe numri i aplikimeve fituese për lehtësuesit përbëjnë 22% kundrejt totalit të aplikimeve për lehtësues.</p>		<p>të Vlerësimit, i nivelit të grantit për çdo përfitues startup ose lehtësues të kualifikuar si fitues;</p> <p>d. Nuk ka një përshkrim mbi mënyrën si do të klasifikohet aplikimi nga fitues në jo fitues apo anasjelltas, kundrejt pikëve të vlerësuar nga komisioni i vlerësimit. Në rregulloren e grantit mungon kriteri i pikëve, nën të cilin aplikimi nuk kualifikohet, pasi është cilësuar se: “Fituesit do të shpallen sipas renditjes së pikëve të mbledhura, në raport me fondin total në dispozicion.”</p> <p>e. Mungon emërtimin specifik apo i përgjithshëm në lidhje me thirrjen për grant.</p> <p>f. Mungon parashikimi mbi dokumentin justifikues që duhet të paraqesë çdo aplikant në mbështetje të formatit të buxhetit për çdo projekt konkurrues.</p>
---	--	--

1.3. Konkluzioni dhe opinioni i auditimit:

Opinion i pamodifikuar / pakualifikuar.¹

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se veprimtaria e institucionit të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në të gjitha aspektet është kryer në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi dhe justifikon dhënien e një “Opinionit të Pakualifikuar”.

Baza për opinionin e pa modifikuar /pa kualifikuar të përputhshmërisë:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Parimet Themelore Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik, me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAIs), në parimet INTOSAI-P1, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në

¹- Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, (Qershor 2020, fq.104), Kapitulli VII, pika 7.3.3 “Angazhimet e Vërtetimit me Siguri të Arsyeshme”, Konkluzionet/ Opinione të Pakualifikuara:

“Kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinionin të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është i pavarur nga institucioni i audituar dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe kabineti i saj janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit përfundimtar të auditimit. Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur sipas përcaktimeve ligjore është vendosur që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 792/2 prot, datë 19.09.2022, në institucionin e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Tiranë, nga data 09.09.2022 – 31.10.2022, për periudhën nga 01.01.2017 deri në 30.06.2022, u krye Auditimi i Përputhshmërisë, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Q.C (përgjegjës grupi),
2. I.I, anëtar
3. D.P anëtar

a) Titulli:

Raport Përfundimtar i Auditimit të Përputhshmërisë në institucionin e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

b) Marrësi:

Ky raport i adresohet znj. E.B, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit është përputhshmëria e veprimtarisë së institucionit të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu detyrat sipas fushës së përgjegjësisë si dhe sistemin e kontrollit të brendshëm të institucionit.

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” në nenin 3 të tij ka përcaktuar se, “*Auditimi i përputhshmërisë nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve,*



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

mbi të cilat është rënë dakord". Në nenin 12 "Auditimi i përputhshmërisë", të po këtij ligji, është përcaktuar ndër të tjera se: "Në auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik".

Referuar Standardit Ndërkombëtar të Auditimit ISSAI 4000 / paragrafi 23, Objektivi kryesor i auditimit të përputhshmërisë është t'i sigurojë përdoruesit të synuar informacione nëse entiteti publik i audituar ndjek *ligjet, aktet legislative, politikat, kodet e përcaktuara dhe termat e dakordësuar*.

Objektivat e auditimit synojnë:

- a) Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.
- b) Aspektet e *rregullshmërisë* (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe *ligjshmërisë* (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë veprimtarinë dhe sjelljen e zyrtarëve publik).
- c) Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre.
- d) Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

Qëllimi i auditimit është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë e tij, institucioni i Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, dhe mbi këtë bazë, dhënia e opinionit mbi rregullshmërinë dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime².

b) Identifikimi i çështjes:

Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të titullarëve dhe stafëve mbështetëse për realizimin e përgjegjësive publike.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtuar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Raporti i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve,

² -Rregullorja e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 8.9.2017, të ndryshuar, të Kryetarit të KLSH.



KONTROLLI I LARTË I SHETITIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË
SHETITIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset e raportit.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr.792/2, datë 19.9.2022.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe stafi politik mbështetës (Kabineti i Ministrit), janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator, për të mbështetur sipërmarrjen dhe menaxhuar burimet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Koncepti i përputhshmërisë (pajtueshmërisë) merr një rëndësi të veçantë në kushtet kur kërkesa për performancë në sektorin publik është gjithnjë në rritje, dhe marrja e sigurisë referuar përputhshmërisë me ligjet dhe rregullat, konsiderohet si një dimension jetik i përgjegjshmërisë dhe transparencës në qeverisje.

Titullarë dhe drejtues politikë të kabinetit të këtij institucioni për periudhën objekt auditimi janë:

- I. Znj. S.Q, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, sipas Dekretit të Presidentit të Republikës, me Nr. 10618, datë 10.9.2017 “Për emërim ministri”, për periudhën nga data 10.09.2017 – 16.01.2019 dhe znj. E.G, drejtor i Kabinetit të Ministrit;
- II. Z. E.Sh, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, sipas Dekretit të Presidentit të Republikës, me Nr. 11036, datë 05.01.2019 “Për emërim ministri” për periudhën nga data 06.01.2019 deri në datën 17.09.2021 dhe z. A.P drejtor i Kabinetit të Ministrit (1.2.2019 deri 16.9.2021);
- III. Znj. E.B, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, sipas Dekretit të Presidentit të Republikës, meNr.13213, datë 14.9.2021, datë 10.9.2017 “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”, për periudhën 17.9.2021 e në vijim. Z. E.Ç, drejtor i Kabinetit të Ministrit; për periudhën nga data 01.10.2021 deri 18.4.2022 dhe znj. M.G, drejtor i Kabinetit të Ministrit; për periudhën nga data 18.4.2022 deri në datën e mbajtjes së këtij raporti.

d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Raporti i auditimit duhet të deklarojë që përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi përputhshmërinë bazuar mbi auditimin. Raporti i auditimit duhet të shprehë që auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Gjithashtu, raporti i audituesit duhet të shpjegojë që këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin / opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar me objekt: *dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit e KLSH marrin evidenca të besueshme, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e dala lidhur me organizimin, veprimtarinë, programin dhe funksionet e subjekteve nën auditim. Gjithashtu, audituesit e KLSH kanë përzgjedhur dhe përdorur metoda të përshtatshme për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave që plotësojnë kriteret e përcaktuara për këtë auditim, si dhe janë siguruar se teknikat e përdorura janë të mjaftueshme e të arsyeshme për të evidentuar parregullsitë në veprimtarinë e Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Në zgjedhjen e metodave dhe procedurave, është marrë në konsideratë veçoria e subjektit që auditohet, si dhe cilësia e evidencave dhe dëshmimeve.

Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, përkatësisht ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit në Sektorin Publik” (rishikimi i vitit 2019), paragrafi 41 “Materialiteti” dhe ISSAI 400 “Parimet e auditimit të përputhshmërisë”, (rishikimi i vitit 2019), paragrafi 47, ku nënvizohet se:

“Audituesit duhet të marrin në konsideratë materialitetin gjatë gjithë procesit të auditimit. Përcaktimi i materialitetit është çështje gjykimi profesional dhe varet në interpretimin e audituesit të nevojave të përdoruesve. Një çështje mund të gjykohet material nëse njohuritë për të do të kishin të ngjarë të ndikonin në vendimet e përdoruesit e synuar. Ky gjykim mund të ketë të bëjë me një çështje individual ose me një grup të çështjeve të marra së bashku. Materialiteti shpesh konsiderohet në kuptim të vlerës, por gjithashtu ka aspekte të tjera sasiore si dhe cilësore. Karakteristikat e qenësishme të një çështjeje ose grupi të çështjeve mund të jenë materiale nga vetë natyra e saj. Një çështje mund të jetë gjithashtu materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodh”.

Sa më sipër, audituesit aplikojnë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së angazhimit të auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth raportimit të të dhënave dhe informacioneve. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në institucionin e auditimit, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

e) Kriteret e vlerësimit:

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

Standardet e auditimit:	<ul style="list-style-type: none">- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 100, 400, etj.;- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI¹, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH;- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
Ligje:	<ul style="list-style-type: none">- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	<p>Kontrollit të Lartë të Shtetit”;</p> <ul style="list-style-type: none">- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;- Ligji nr. 25/2022, datë 10.3.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”;- Ligj nr. 44/20151 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
VKM:	<ul style="list-style-type: none">- VKM nr.511, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes”.- VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes”.- VKM nr. 311, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për veprimtarinë dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit Start up One Stop Shop si dhe shërbimeve për të cilat aplikohet tarifa zero për mbështetjen e startupeve”.- VKM nr. 312, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për përmbajtjen e regjistrit të startupeve dhe lehtësuesve, mënyrën e funksionimit dhe ndërlidhjen e tij me portalin qeveritar E-Albania si dhe për dokumentet elektronike- Pasaporta e Start up eve dhe Pasaporta e Lehtësuesve”.- VKM nr. 313, datë 11.05.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit si dhe kriteret e procedurat së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarve të tij”.- VKM nr. 314, datë 11.05.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit si dhe kriteret e procedurat së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarve të Këshillit të Stratupeve”.- VKM nr. 315, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e kërkesave dhe kriterëve që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve si dhe miratimin e procedurave dhe afateve të thirrjes për përfitimin e granteve dhe masave mbështetëse”.
Rregullore:	<ul style="list-style-type: none">- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH^{së}”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH^{së} nr. 85, datë 30.06.2015, e ndryshuar;- Rregullore e Brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH^{së} e ndryshuar;- Rregullore e MiSHMS “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve që aplikojnë për masa mbështetëse”.- Rregullore e Brendshme për funksionimin dhe organizimin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, etj.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohej për ushtrimin e gjyqimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to.

Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet dhe projekt raportin e auditimit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjyqimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur vlerësimet / përfundimet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tij.

Dokumenti i rezultateve të angazhimit:

📁 Me shkresën nr. 792/5, datë 02.12.2022 të KLSH është dërguar zyrtarisht Projekt Raporti i Auditimit në institucionin e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim njohjen me gjetjet dhe rekomandimet dhe konfirmimin e tyre.

📁 Sipas shkresës me nr. 4979/10, datë 04.01.2023, (protokolluar në KLSH me nr. 792/6 prot, datë 09.01.2023), institucioni i Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka konfirmuar punën për adresimin e çështjeve të trajtuara në Projekt Raportin e auditimit, për hartimin e përmirësimit dhe përditësimit akteve që miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, pasi Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes funksionon me kabinet, një staf i ngushtë këshilltarësh; veprimtaria e të cilit është rregulluar sipas përcaktimeve të VKM nr.511, datë 13.09.2017 si dhe të VKM nr. 610, datë 20.10.2021“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit;

c. *Verifikimi në sistemin elektronik* - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm

Referuar përcaktimeve të nenit 3 dhe 4, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

“Ministri i Shtetit dhe kabineti i tij, janë në strukturë dhe përbërje të Kryeministrit, e cila është person juridik, publik, që mbështet veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe të Ministrit të Shtetit”.

Sipas përcaktimeve në dokumentet e politikave si dhe në VKM nr.511, datë 13.09.2017 dhe nr. 610, datë 20.10.2021, misioni i Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është të ndihmojë dhe të mbrojë sipërmarrjen private, që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, si dhe të promovojë bashkëpunimin ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes e përmbush misionin e ndërmarrë nëpërmjet shqyrtimit, ndjekjes dhe trajtimit të ankesave administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të cilat përfshijnë institucionet publike të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike si dhe të zyrtarëve të tyre. Një ndër detyrat e rëndësishme të këtij Institucioni është dhe përpunimi dhe propozimi i përmirësimeve të nevojshme funksionale, për platformën elektronike të ndërveprimit me sipërmarrjen për komunikimin dhe gjurmimin e ankesave të tyre, si dhe për regjistrin e komunikimit të brendshëm të trajtimit të ankesave, përmes të cilit monitoron procesin ndërinstitucional.

Referuar këtyre përcaktimeve, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes synon të promovojë transparencën dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike, si dhe asiston sipërmarrjen në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore të lidhura me aktivitetet e tyre sipërmarrëse, kundrejt institucioneve publike; ndërmjetëson komunikimin dhe zhvillimin e partneritetit të sipërmarrjes me institucionet publike; identifikon pengesat e biznesit në sektorë të caktuar të ekonomisë dhe formulon strategjitë e ndërhyrjes për reduktimin e barrierave administrative. Institucioni i Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në monitorimin e indikatorëve sasiorë dhe cilësorë të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen si dhe propozimi i mekanizmeve institucionale/ndërinstitucionale në funksion të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen, është gjithashtu themelor për përmbushjen e misionit të tij.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- *Objekt i këtij auditimi* është auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së institucionit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MiSHMS) me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të institucionit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË
SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

- *Qëllimi i auditimit:* Vlerësimi nëse aktivitetet, procedurat dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë institucioni i MiSHMS.

- *Fushëveprimi i auditimit:* Vlerësimi i aktivitetit dhe Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes me qëllim dhënien e opinionit, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit për periudhën objekt auditimi 01.01.2017-30.06.2022.

IV. DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Auditimi për krijimin dhe funksionimin e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për periudhën objekt auditimi. Auditimi mbi shqyrtimin dhe ndjekjen e ankesave administrative të sipërmarrjes Private, përfshirë dhe ato të investitorëve strategjikë dhe /ose të huaj, kundrejt institucioneve publike.

1.A- Krijimi dhe funksionimi i ministrit të shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes, roli dhe përgjegjësitë e tij ligjore si institucion publik.

Përgjatë periudhës së auditimit, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes e ka ushtruar aktivitetin e tij bazuar në VKM nr. 511, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes” dhe, në vijim, VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, akt i cili shfuqizon pararendësin dhe konsiston në disa shtesa në fushën e përgjegjesisë.

Misioni i Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është të ndihmojë dhe të mbrojë sipërmarrjen private, që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, si dhe të promovojë bashkëpunimin ndër-institucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen.

Ligji nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” përcakton rregullat bazë, procedurat, si dhe organet shtetërore kompetente për vetë deklarin, mbështetjen, zhvillimin dhe monitorimin e startup-eve dhe të ekosistemit mbështetës të tyre në Republikën e Shqipërisë. Ky akt ligjor u pasua edhe me aktet nënligjore që rregullonin në mënyrë më të hollësishme procesin e asistimit të startup-eve, si më poshtë:

- VKM nr. 311, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit startup one-stop-shop, si dhe shërbimeve për të cilat aplikohet tarifa zero për mbështetjen e startup-eve”;
- VKM nr. 312, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për përmbajtjen e regjistrimit të startup-eve dhe lehtësuesve, mënyrën e funksionimit dhe ndërlidhjen e tij me portalin qeveritar “e-albania”, si dhe dokumentet elektronike – pasaporta e startup-eve dhe pasaporta e lehtësuesve”;
- VKM nr. 313, datë 11.05.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të kritereve të procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”;



KONTROLLI I LARTË I SHETITIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË
SHETITIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

- VKM nr. 314, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, funksionimin, përbërjen, kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes, si dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të startup-eve”;
- VKM nr. 315, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e kërkesave dhe kriterëve që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve, si dhe miratimin e procedurave dhe afateve të thirrjes për përfitimin e granteve dhe masave mbështetëse”.

Veprimtaria e institucionit të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është mbështetur në dy dokumente të rëndësishëm mbi funksionimin e tij, sikurse janë “Rregullorja e Brendshme për funksionimin dhe organizimin e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes” dhe “Strategjia për ndërveprim mes sipërmarrjes dhe institucioneve publike”, dokumente këto të publikuara edhe në faqen zyrtare të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ku gjejnë përcaktim vizioni, prioritetet, objektivat dhe arritjet e synuara të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, etj. Disa nga objektivat dhe arritjet e synuara të përcaktuara në këtë strategji janë, ndër të tjera:

- (i) përmirësimi i renditjes së Shqipërisë në raportet ndërkombëtare të biznesit;
- (ii) rritja e bashkëpunimit për nxitjen e më shumë investimeve vendase dhe të huaja në Shqipëri;
- (iii) përmirësimi i dialogut ndërmjet sipërmarrjes private dhe botës akademike, me qëllim përgatitjen e burimeve njerëzore në përputhje me nevojat aktuale të tregut të punës në Shqipëri;
- (iv) ngritja e një strukture eficiente për trajtimin dhe ndjekjen e ankesave të adresuara nga sipërmarrja, duke garantuar reduktimin e problematikave të sipërmarrjes vendase dhe të huaj ndaj administratës shtetërore;
- (v) trajtimi në masë 100% të ankesave të ardhura nga sipërmarrja, me një marzh zgjidhjeje prej më shumë se 60%;
- (vi) botimi dhe shpërndarja e raporteve për çdo muaj mbi trajtimin e ankesave të sipërmarrjes, në shqip dhe anglisht.

Konstatim nr.1:

Për periudhën objekt analize e vlerësimi (nga data 10.9.2017 deri më datën e mbajtjes së raportit të auditimit), MiSHMS ka vijuar veprimtarinë sipas rregullores së brendshme të hartuar në zbatim të pikës 4/c, të VKM nr. 511, datë 13.09.2017, akt i shfuqizuar dhe i referohet atij akti. Rregullorja e Brendshme për funksionimin dhe organizimin e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes³, nuk ka reflektuar përmirësimet e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. Sa më sipër, nuk ka gjetur zbatim nga ana e MiSHMS, detyrimi i pikës nr. 4/b, të VKM nr. 610, datë 20.10.2021. Dokumentet e rregullores së brendshme dhe të Strategjisë nuk kanë reflektuar lidhjen me rolin e MiSHMS në kuadër të Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar³, funksione dhe veprimtarinë që kanë si bazë Ligjin nr.57/2014 “Për Këshillin Ekonomik Kombëtar” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.281, datë 16.5.2018.

Përfundimi:

Titulli i Gjetjes Nr.1	<i>Institucioni i MiSHMS për periudhën 01.09.2017 deri më 30.6.2022 ka kryer veprimtarinë sipas rregullores së brendshme të hartuar në zbatim të pikës 4/c, të VKM nr. 511, datë 13.09.2017, akt ky i shfuqizuar.</i>
-----------------------------------	--

³ Linku: <https://sipermarria.gov.al/wp-content/uploads/2018/12/RREGULLORE-E-BRENDSHME-.pdf>



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	<p><i>Strategjia për Ndërveprim mes Sipërmarrjes dhe Institucioneve Publike është dokument i përgatitur nga ana e MiSHMS në vitin 2018, por që nuk i është nënshtruar rishikimit çdo 3 vjet, në kundërshtim me kërkesat e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik.</i></p>
Situata	<p>Rregullorja e Brendshme për funksionimin dhe organizimin e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes⁴, nuk ka reflektuar përmirësimet e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. <i>Sa më sipër</i>, nuk ka gjetur zbatim nga ana e MiSHMS, detyrimi i pikës nr. 4/b, të VKM nr. 610, datë 20.10.2021. Dokumentet e rregullores së brendshme dhe të Strategjisë nuk kanë reflektuar lidhjen me rolin e MiSHMS në kuadër të Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar”, funksione dhe veprimtarinë që kanë si bazë Ligjin nr.57/2014 “Për Këshillin Ekonomik Kombëtar” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.281, datë 16.5.2018.</p> <p><i>Sa më sipër</i>, nuk ka gjetur zbatim nga ana e MiSHMS, detyrimi i pikës nr. 4/b, të VKM nr. 610, date 20.10.2021. Dokumentet e rregullores së brendshme dhe të Strategjisë nuk kanë reflektuar lidhjen me rolin e MiSHMS në kuadër të Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar”, funksione dhe veprimtarinë që kanë si bazë Ligjin nr.57/2014 “Për Këshillin Ekonomik Kombëtar” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.281, datë 16.5.2018.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">• neni 7, pika 4, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”;• neni 29, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;• neni 8” Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika nr.1 dhe nr.8, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;• pika nr. 4/b, të VKM nr. 610, date 20.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”;• neni 21, pika nr.2, e ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ku sanksionohet se, “.....titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit”.
Ndikimi/Efekti:	<p>Mungesa e një dokumenti të përditësuar, që përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin dhe marrëdhëniet ndërmjet niveleve të ndryshme të administratës së ministrisë, duke mbajtur në konsideratë natyrën dhe kushtet specifike të veprimtarisë së saj në raport me aktorët e tjerë si Kryeministria, Këshilli i Ministrave, Sekretariati teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar, dhe mungesa e përditësimit të Strategjisë, etj.</p>

⁴ Linku: <https://sipermarria.gov.al/wp-content/uploads/2018/12/RREGULLORE-E-BRENDSHME-.pdf>



KONTROLLI I LARTË I SHETITIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETITIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	<p>1. Nga ana e institucionit të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të merren masat për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të institucionit, në përputhje me detyrimet që rrjedhin sipas pikës nr. 4/b, të VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, duke përcaktuar rregullat lidhur me organizimin, funksionimin e brendshëm dhe veprimtarinë e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, detyrat funksionale të përgjithshme dhe të veçanta të Kabinetit, metodat e brendshme të punës dhe mbarëvajtjen dhe disiplinën në marrëdhëniet e punës dhe etikën profesionale të stafit, procedurat e komunikimit ndërmjet tyre dhe Koordinatorit përkatës në Zyrën e Bashkëqeverisjes, etj. Dokumenti i rregullores së brendshme duhet të pasqyrojë rolin e MiSHMS në kuadër të Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar”, funksione dhe veprimtari që kanë si bazë Ligjin nr.57/2014 “Për Këshillin Ekonomik Kombëtar” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.281, datë 16.5.2018.</p> <p>2. Të merren masat për rishikimin dhe miratimin e Strategjisë për Ndërveprim mes Sipërmarrjes dhe Institucioneve Publike, bazuar në kompetencat dhe ridimensionimin e rolit dhe funksioneve të MiSHMS, jo vetëm si mekanizmi që u mundëson bizneseve të kanalizojnë dhe të advokojnë shqetësimet dhe propozimet e tyre për Qeverinë, por edhe si dhe një instrument për të ndërmjetësuar dhe lehtësuar komunikimin mes sipërmarrjes dhe institucioneve publike dhe për nxitjen e startup-eve. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes të marrë masat për hartimin e një strategjie institucionale, ku të përfshihen objektiva SMART (specifikë, të matshëm, të arritshëm, të përshtatshëm dhe me kohë të përcaktuar), me plan-veprimet përkatëse, ku dhe të përcaktohet metodologjia e monitorimit periodik të saj.</p>
Afati	Brenda 3 muajsh

Konstatim nr.2:

Fusha e përgjegjesisë së Ministrisë është miratuar me VKM nr. 511, datë 13.09.2017 për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, i cili është shfuqizuar nga VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”.

Konstatohet se fusha e kompetencave dhe përgjegjësive të këtij institucioni publik kanë elementë të mbivendosjes së tyre me ato të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, institucion i krijuar nga Ligji Nr. 107/2021, datë 4.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”.

Pika 2, e nenit 7, të Ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” përcakton se fusha e veprimtarisë shtetërore, që përfshihet brenda një ministrie, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Duke marrë parasysh ndryshimet që kanë ndodhur në akte ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ligjore e nënligjore të reja që kanë hyrë në fuqi, *de iure dhe de facto* konstatohet që, fusha e veprimtarisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

shtetërore të MiSHMS ka ndryshuar, duke kaluar nga një institucion që synon mbrojtjen e sipërmarrjes, në një institucion promovues të sipërmarrjes dhe të startup-eve.

Ky ndryshim i fushëveprimit, përgjegjësive dhe kompetencave të MiSHMS nuk është reflektuar me ndonjë ndryshim në VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”.

Më hollësisht,

Grupi i auditimit konstaton se, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 107/2021, datë 04.11.2021, “Për bashkëqeverisjen”, të gjitha rastet e ankesave që mbërrijnë pranë MiSHMS delegohen elektronikisht në platformën “Për Shqipërinë që duam”. Neni 25 “Biznesi im” i këtij ligji përcakton se të gjitha ankesat e biznesit duhet të kanalizohen nëpërmjet platformës dhe se Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e procedurave të trajtimit të këtyre ankesave, për këtë arsye, stafi i MiSHMS shprehet se institucioni pritës i këtyre ankesave nuk është më ky institucion, por platforma elektronike.

Pra, rezulton që, kompetencat dhe fusha e përgjegjësive që më parë i takonte MiSHMS, referuar akteve nënligjore që përcaktonin fushën e përgjegjësive shtetërore, me anë të këtij neni, i janë atribuar një institucioni tjetër, kjo edhe pasi në hierarkinë e normave juridike, ligji pre valon mbi aktet nënligjore. Audituesit e autorizuar të KLSH evidentojnë se, ky ndryshim i fushëveprimit nuk është reflektuar me një ndryshim në VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”.

Më konkretisht,

A. Të dy institucionet kanë të njëjtin fokus dhe qëllim kryesor, që përmbledhet në përmirësimin e shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen. Kështu,

- Neni 2, i ligjit Nr. 107/2021, datë 4.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”, shpreh se qëllimi i këtij ligji është **krijimi i kushteve dhe nxitja e ndërveprimit ndërmjet administratës shtetërore dhe individëve, personave fizikë dhe juridikë dhe grupeve të interesit**, pavarësisht formës së tyre të organizimit, me qëllim rritjen e rolit të tyre në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike, si dhe ndërmarrjen e nismave, të projekteve ose të programeve të përbashkëta që kanë si qëllim përfshirjen e qytetarëve në bashkëqeverisje përmes platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”.
- Po kështu, **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, Misioni i MiSHMS është të ndihmojë dhe të mbrojë sipërmarrjen private**, që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, si dhe të promovojë bashkëpunimin ndër-institucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen.

B.Lidhur me objektin dhe kompetencat:

- Në piken nr.3, të VKM nr. 511, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes”, thuhet: “Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:
 - a) Investigon dhe trajton ankesat administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të cilat përfshijnë institucionet publike të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike si dhe të zyrtarëve të tyre;



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

- b) Promovon transparencën dhe bashkë-punimin ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike, si dhe asiston sipërmarrjen në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore të lidhura me aktivitetet e tyre sipërmarrëse, kundrejt institucioneve publike;
- c) Ndërmjetëson komunikimin e sipërmarrjes me institucionet publike për zbatimin e kontratave, si dhe zhvillon mekanizma të zgjidhjes paraprake të mosmarrëveshjeve midis tyre;
- ç) Inkurajon zhvillimin e partneritetit dhe komunikimit midis institucioneve publike dhe sipërmarrjeve, si dhe organizatave përfaqësuese të tyre.
- **Në pikën nr.3, të VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”:**
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes e ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore: a) Shqyrton, ndjek dhe trajton ankesat administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të cilat përfshijnë institucionet publike të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike si dhe të zyrtarëve të tyre; b) Promovon transparencën dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike, si dhe asiston sipërmarrjen në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore të lidhura me aktivitetet e tyre sipërmarrëse, kundrejt institucioneve publike; c) Ndërmjetëson komunikimin e sipërmarrjes me institucionet publike për zbatimin e kontratave, si dhe zhvillon mekanizma të zgjidhjes paraprake të mosmarrëveshjeve midis tyre; ç) Inkurajon zhvillimin e partneritetit dhe të komunikimit ndërmjet institucioneve publike dhe sipërmarrjeve, si dhe organizatave përfaqësuese të tyre; d) Identifikon pengesat e biznesit në sektorë të caktuar të ekonomisë dhe formulon strategjitë e ndërhyrjes për reduktimin e barrierave administrative. dh)Angazhohet në monitorimin e indikatorëve sasiorë dhe cilësorë të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen; e) Propozon mekanizma institucionalë/ndërinstitucionalë në funksion të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen.
 - **Në nenin 12, “Kompetencat e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”, të ligjit Nr. 107/2021 , datë 4.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”, nënvizohet se:**
Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, më poshtë “Agjencia”, ka këto kompetenca:
a) zhvillon mekanizmat dhe monitoron zbatimin e tyre për gjithë përfshirjen e qytetarëve në politikë bërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjen e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore;
ë) *kontrollon veprimtarinë administrative që kryhet nga institucionet e administratës shtetërore për ofrimin e shërbimeve publike sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj;*
f) *ndërmjetëson zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet institucionit të administratës shtetërore, qytetarëve apo subjekteve private sipas përcaktimeve të këtij ligji;*
g) inspekton zbatueshmërinë e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, si dhe monitoron ndjekjen e masave të dhëna në zbatim të nenit 56 të tij;
gj) *administron bazën e të dhënave të platformës “Me ty për Shqipërinë që duam” dhe propozon ndryshime në varësi të nevojës për përmirësim të platformës;*
- si dhe neni 17, i po këtij ligji
- 1. Metodat e platformës, të paraqitura sipas seksioneve në platformë, ndahen në varësi të përmbajtjes së çështjeve që adresohen: a) metoda e kontrollit, ku përfshihen të gjitha ankesat e*



KONTROLLI I LARTË I SHETITIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETITIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

ardhura nga qytetarë ose persona fizikë apo juridikë ose çështje të denoncimit të korrupsionit të paraqitura në seksionet: **“Ankesa ime”, “Biznesi im”, “Denonco korrupsionin”;**

2.Seksionet e platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”, sipas metodave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, janë: a) **“Ankesa ime”** - Nëpërmjet këtij seksioni paraqiten ankesat për vonesën në marrjen e shërbimit publik apo mos përfitimin e tij, si dhe raportohen sjelljet abuzive të strukturave të administratës shtetërore ose të zyrtarëve të caktuar; b) **“Biznesi im”** - Nëpërmjet këtij seksioni çdo subjekt privat i pajisur me NIPT ankimon sjelljet abuzive apo joetike, si dhe çdo parregullsi të administratës, të cilat cenojnë klimën e biznesit dhe denoncon vendimmarrje që bien në kundërshtim me aktet rregullatore; c) **“Denonco korrupsionin”** - Nëpërmjet këtij seksioni denoncohen aktet korruptive apo kur konstatohet se në përmbajtje të çështjes ka elemente të një akti korruptiv të ndodhur ose në tentativë;

Në lidhje me sa më sipër, me anë të shkresës nr. 4979/10, datë 04.01.202, të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, protokolluar në KLSH me nr. 792/6 prot., datë 09.01.2023, është theksuar si më poshtë:

Qëndrimi i subjektit, MiSHMS:

Kemi në proces përfundimi draftin e aktit të duhur për amendim të VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, siç edhe rekomandohet nga ana e auditit të KLSH-së, në Kreu A “Propozime për ndryshime apo përmirësim të legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi, rekomandimi nr. 1.1, i projekt raportit të auditimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka vlerësuar faktin se, MiSHMS ka filluar procesin e ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të dërguara në projekt-raportin e auditimit të përputhshmërisë, të ushtruar në këtë institucion. Duke qenë se përgjigjja e MiSHMS nuk sjell argumente të tjera ligjore përveç atyre të shqyrtuara dhe diskutuara më parë, kërkohet zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti përfundimtar të auditimit.

Titulli i Gjetjes Nr.2

Gjatë periudhës objekt auditimi rezulton se, fusha e e përgjegjësisë dhe e kompetencave të këtij institucioni publik, (miratuar me VKM nr. 511, datë 13.09.2017 për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, shfuqizuar nga VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes), ka elementë të mbivendosjes së tyre me ato të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, institucion i krijuar nga Ligji Nr.107/2021, datë 4.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”.

Pika 2, e nenit 7, të Ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” përcakton se fusha e veprimtarisë shtetërore, që përfshihet brenda një ministrie, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Duke marrë parasysh ndryshimet që kanë ndodhur në akte ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ligjore e nënligjore të reja që kanë hyrë në fuqi, *de iure dhe de facto* konstatohet që, fusha e veprimtarisë shtetërore të MiSHMS ka ndryshuar, duke kaluar nga një institucion që synon mbrojtjen e sipërmarrjes, në një



KONTROLLI I LARTË I SHETITIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETITIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	<p>institucion promovues të sipërmarrjes dhe të startup-eve.</p> <p>Ky ndryshim i fushëveprimit, përgjegjësive dhe kompetencave të MiSHMS nuk është reflektuar me ndonjë ndryshim në VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”.</p>
Situata	<p>Pika nr.2, e nenit 7, të Ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” përcakton se fusha e veprimtarisë shtetërore, që përfshihet brenda një ministrie, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Duke marrë parasysh ndryshimet që kanë ndodhur në akte ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ligjore e nënligjore të reja që kanë hyrë në fuqi, <i>de iure dhe de facto</i> konstatohet që, fusha e veprimtarisë shtetërore të MiSHMS ka ndryshuar, duke kaluar nga një institucion që synon mbrojtjen e sipërmarrjes, në një institucion promovues të sipërmarrjes dhe të startup-eve.</p> <p>Ky ndryshim i fushëveprimit, përgjegjësive dhe kompetencave të MiSHMS nuk është reflektuar me ndonjë ndryshim në VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">• pika 2, e nenit 7, të Ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” ,• pika nr.3, të VKM nr. 511, datë 13.09.2017 për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes”,• pika nr.3, të VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes,• neni 2 dhe 12,”Kompetencat e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”, të ligjit Nr. 107/2021, datë 4.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”.
Ndikimi/Efekti:	<p>Mbivendosja e kompetencave dhe përgjegjësive dhe mos identifikimi i saktë e i duhur, i rolit dhe përgjegjësive midis institucioneve shtetërore mbart riskun e mos adresimit në kohë të shqetësimeve të biznesit dhe publikimin e mbivendosjen e detyrave, si një kosto shtesë për administratën publike.</p>
Shkaku:	<p>Mos marrja e masave të nevojshme për miratimin e përmirësimeve në kohë të këtij akti.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p>
Rekomandime:	<p>Sa më sipër, nga ana e institucionit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në bashkëpunimin me Kryeministrinë, për të evituar përplasjet e mundshme të kompetencave dhe të fushës së përgjegjësive zyrtare, me qëllim qartësimin e objektit të veprimtarisë, të merren masat për ngritjen e një grupi pune për rishikimin dhe ridimensionimin e fushës së veprimtarisë, hartimin dhe propozimin e ndryshimeve të nevojshme, për të paraqitur sa më drejtë rolin, misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË
SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	institucionit, përmes ndryshimeve në VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, duke kaluar nga një institucion që ka patur objekt mbrojtjen e sipërmarrjes, në një institucion promovues të sipërmarrjes dhe nxitjes së startup-eve.
Afati	Menjëherë e në vijimësi

I.B - Shqyrtimi dhe ndjekja e ankesave administrative të sipërmarrjes private kundrejt institucioneve publike.

Konstatim nr.3:

Kontrolli i Lartë i Shtetit konstaton se, nga strukturat përgjegjëse në MiSHMS, nuk janë marrë masat për hartimin dhe miratimin e një Rregulloreje për Trajtimin e Ankesave, si një dokument udhëzues metodik që disiplinon procesin e regjistrimit, identifikimit, kategorizimit e shqyrtimit, procedurat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve dhe ri kërkimit të informacioneve shtesë, analizimit të ecurisë dhe mbledhjes së informacionit standard e të domosdoshëm për zgjidhjen e ankesave brenda afateve të miratuara, gjurmimin e ankesave, ndjekjen dhe trajtimin në ankesave administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike, si dhe të zyrtarëve të tyre.

Kështu,

Referuar VKM nr. 511, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes” dhe, në vijim, VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes” një nga misionet e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është të ndihmojë dhe të mbrojë sipërmarrjen private, që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë. Një nga detyrat kryesore të tij në përgjegjësinë shtetërore që i atribuohet është shqyrtimi, ndjekja dhe trajtimi i ankesave administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të cilat përfshijnë institucionet publike të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike, si dhe të zyrtarëve të tyre.

Germa “a” e nenit 4, të VKM nr. 610, datë 20.10.2021, përcakton se ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes përpunon dhe propozon përmirësimet e nevojshme funksionale, për platformën elektronike të ndërveprimit me sipërmarrjen për komunikimin dhe gjurmimin e ankesave të tyre, si dhe për regjistrin e komunikimit të brendshëm të trajtimit të ankesave, përmes të cilit monitoron procesin ndërinstitutional dhe i raporton Kryeministrit çdo fillim muaji.

Nga auditimi u konstatua se regjistri i komunikimit të brendshëm të trajtimit të ankesave gjeneron të dhëna deri në muajin korrik 2021, prej të cilave ka hartuar dhe publikuar raporte mujore deri në muajin nëntor 2020.

Gërma “b” e nenit 4, të VKM nr. 610, datë 20.10.2021 përcakton se ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes krijon rregulloren e procedurës së brendshme, e cila detajon procedurën e (i) regjistrimit dhe të pranimit të ankesave, sipas kriterëve të përcaktuara në rregullore; (ii) komunikimit dhe të investigimit të çështjeve të pranuar me institucionet e lidhura publike; (iii) mbledhjes së evidencave dhe të informacionit të nevojshëm nga institucione të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike dhe/ose personave të tretë; (iv) komunikimit ndërmjet institucioneve



publike dhe të sipërmarrjes që ka kryer ankimimin; dhe (v) raportimit dhe publikimit të statusit të ankesave të trajtuara.

MiSHMS ka vijuar punën me rregulloren e brendshme të hartuar përpara daljes së VKM nr. 610, dt. 20.10.2021. Kjo rregullore përshkruan shkurtimisht procedurën e regjistrimit dhe të pranimit të ankesave, afatet për dorëzimin e praktikës, si dhe raportimet.

Sa i përket *afateve*, rregullorja parashikon se afatet do të jenë *normale, prioritare ose urgjente*, në varësi të çështjes, por nuk specifikon sa ekzaktësisht do të jenë afatet për secilën prej ndarjeve. Gjithashtu, rregullorja parashikon se në rast vonesash, strukturat përgjegjëse duhet të informojnë me shkrim duke dhënë arsyet e vonesës për trajtimin e praktikës, si dhe duke propozuar një afat tjetër të mundshëm për realizimin e detyrës.

Sa i përket *raportimit*, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Kabineti monitoron dhe publikon statusin e ankesave të trajtuara, raporton procesin ndërinstitucional çdo fillim muaji tek Kryeministri, si dhe për efekt transparence, publikon këto raporte mujore në faqen online. Që nga nëntori 2020, këto raporte nuk janë publikuar në faqen online.

Kjo rregullore nuk detajon se si kryhet mbledhja e evidencave dhe informimit të nevojshëm nga institucionet publike dhe si kryhet komunikimi ndërmjet institucioneve publike dhe të sipërmarrjes që ka kryer ankimimin, jo në përputhje me sa kërkohet në VKM nr. 511, datë 13.09.2017.

Konstatim nr.4

Nga auditimi u konstatua se, Regjistri Analitik i Komunikimit të Brendshëm të Trajtimit të Ankesave është një dokument i regjistruar në *excel*, ku gjenerohen të dhëna për periudhën Janar 2020 - Korrik 2021, prej të cilave janë hartuar dhe publikuar raporte mujore deri në muajin Nëntor 2020. Nga ana e MiSHMS mungon një regjistër fizik (hardcopy), për të regjistruar, dokumentuar dhe ndjekur ankesat, sipas përcaktimeve të Rregullores se Brendshëm të funksionimit të MiSHMS.

Në praktikë, procedura e ndjekur ishte e tillë që, nëpërmjet platformës elektronike, në momentin e administrimit të një ankesë, stafi i MiSHMS e delegonte drejt institucionit publik përkatës. Që në këtë moment, ankesa merrte statusin “*në proces*”, status të cilit do ta mbante deri në momentin që personi i ngarkuar nga institucioni i administratës publike do të raportonte se ankesa ishte trajtuar me përgjigje ose me zgjidhje. Këto raportime do të reflektoheshin në regjistrat e ankesave dhe do të shërbenin për efekt të raportimeve mujore. Nga auditimi është konstatuar se shpesh ankesat në institucione të caktuar raportoheshin për kohë të gjatë “*në proces*”, si dhe nuk rezulton që MiSHMS të ketë patur mekanizma shtytës për institucionet e administratës publike mbi trajtimin në kohë të përshtatshme të këtyre ankesave.

Në faqen zyrtare të Ministrisë së Shtetit për Sipërmarrjen⁵ janë publikuar raportet mujore të trajtimit të ankesave që nga muaji tetor 2017 e deri në muajin nëntor 2020. Grupit të auditimit u është vendosur në dispozicion edhe regjistri elektronik i ankesave, i cili përmban të dhëna të ankesave të ardhura dhe trajtimit të tyre deri në muajin korrik 2021, *pa publikuar asnjë raport mujor në faqen zyrtare, kërkesë kjo e parashikuar në rregulloren e brendshme.*

Në raportet mujore, ankesat e ardhura raportoheshin në tri stative: *trajtuar me zgjidhje, trajtuar me përgjigje dhe në proces.*

⁵<http://www.sipermarrja.gov.al>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Grupi i auditimit auditori procesin e regjistrimit, shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave nga ana e institucionit të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe rezultoi sa më poshtë vijon:

- 1. Një numër procedurash të testuar nga auditimi (mbi 11 raste të tilla), ankesat e subjekteve private ndaj enteve shtetërore janë regjistruar disa herë duke dublikuar dhe evidentuar në këtë mënyrë një numër jo të saktë stokun e përgjithshëm të ankesave që i janë adresuar MiSHMS për tu trajtuar dhe zgjidhur.**

Kështu nga përpunimi i të dhënave për muajin Janar 2020, rezulton kjo situatë e regjistrimit elektronik me përsëritje të ankesave të subjekteve në platformë dhe stadi të tyre të përpunimit në këtë muaj:

- subjekti **“M.Sha”** për **4 regjistrime**, identifikuar me nr. 111, 114,115, 116 dhe

Nr. dokumentit ne platforme	Subjekti	Nr. rendor	Institucioni ndaj të cilit paraqitet ankesa	Data	Ecuria
186356	M.Sha	114	DPD	09.01.2020	Në proces
186357	M.Sha	115	DPD	09.01.2020	Në proces
186361	M.Sha	116	DPD	09.01.2020	Në proces
186352	M.Sha	111	DPD	09.01.2020	Në proces

- subjekti **“RT..L”** për **2 regjistrime**, identifikuar me nr. 402 dhe 403:

192135	RT..L	402	MK	29.01.2020	Në proces
192135	RT..L	403	MK	28.01.2020	Në proces

- subjekti **“G.AL”** për **3 regjistrime**, identifikuar me nr. 414, 416 dhe 417

192379	G.AL	414	MTM	29.01.2020	Në proces
192384	G.AL	416	MTM	29.01.2020	Në proces
192387	G.AL	417	MTM	29.01.2020	Në proces

- subjekti **“B.sh.a”** për **4 regjistrime** në një datë, identifikuar me nr.53,56,58,59:

185871	B.sh.a	53	AKBN	08.01.2020	Në proces
185875	B.sh.a	56	AKBN	08.01.2020	Në proces



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË
SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

185877	B.sh.a	58	AKBN	08.01.2020	Në proces
185878	B.sh.a	59	AKBN	08.01.2020	Në proces

- subjekti **“Bl.sh.a”** për **2 regjistrime** në një datë, identifikuar me nr. 422 dhe 423.

192415	Bl.sh.a	422	MIE	29.01.2020	Në proces
192417	Bl.sh.a	423	MIE	29.01.2020	Në proces

- subjekti **“ISH.F”** për **2 regjistrime** në një datë, identifikuar me nr. 450 dhe 451.

193029	ISH.F	450	MASR	30.01.2020	Në proces
193048	ISH.F 2.	451	MASR	30.01.2020	Në proces

- subjekti **“B.H”** për **2 regjistrime** në një datë, identifikuar me nr.130 dhe 131

186790	B.H	130	QKB	13.01.2020	Trajtuar me zgjidhje
186791	B.H	131	QKB	13.01.2020	Trajtuar me zgjidhje

- subjekti **“I.XH”** për **2 regjistrime** në një datë, identifikuar me nr.456 dhe 457.

193176	I.XH	456	MFE	31.01.2020	Në proces
193176	I.XH	457	MFE	31.01.2020	Në proces

- subjekti **“N.T”** për **2 regjistrime** në një datë, identifikuar me nr.458 dhe 459

193214	N.T	458	MFE	31.01.2020	Në proces
193214	N.T	459	MFE	31.01.2020	Në proces

- subjekti **“B.S”** për **2 regjistrime** në një datë, identifikuar me nr.460 e 461

193216	B.S	460	MFE	31.01.2020	Në proces
193216	B.S	461	MFE	31.01.2020	Në proces

- subjekti **“I.A”** për **2 regjistrime** në një datë, identifikuar me nr.166 e 167

187255	I.A	166	MSHMS	12.01.2020	Trajtuar me
--------	-----	-----	-------	------------	-------------



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

					përgjigje
187266	I.A	167	MSHMS	12.01.2020	Trajtuar me përgjigje

etj.

2. *Në regjistrin e vënë në dispozicion të KLSH, ku janë pasqyruar ankesat e ardhura dhe trajtuara nga MiSHMS, paraqiten të dhëna nga muaji Janar 2020 deri në muajin Korrik 2021, evidentohen ankesa të mbartura nga muaji në muaj, duke rritur stokun e ankesave të biznesit, por pa u zgjidhur përfundimisht.*

Audituesit e KLSH, kanë vërejtur se, pas miratimit të kuadrit ligjor mbi bashkëqeverisjen dhe përcaktimit të rolit të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje në procesin e trajtimit të ankesave, roli i Ministrisë të Shtetit përgjegjëse për sipërmarrjen ka qenë koordinues dhe ankesat janë trajtuar nëpërmjet platformës. Roli i Ministrisë të Shtetit për Sipërmarrjen ka qenë vetëm asistues dhe mbikëqyrës i ankesave dhe kërkesave që janë adresuar nga biznesi, të cilat trajtoheshin nga koordinatoret e biznesit nëpër institucionet e varësisë dhe ministrinë e linje dhe koordinoheshin nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Urdhri i Kryeministrit Nr. 7, date 20.01.2020 e shtjellon pozicionin e Ministrisë të Shtetit për Sipërmarrjen, ndërkohë që në 2 vitet e funksionimit të këtij rrjeti, Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen të vetmet raste që ka trajtuar janë ato kur ka pasur kërkesa për takime me ministrin apo kabinetin e tij. Raportet javore dhe mujore, janë përgatitur nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje. Historiku i të gjitha rasteve ndodhet në platformën e bashkëqeverisjes ku shihet se çfarë rastesh janë trajtuar (apo nuk janë trajtuar) nga ana e kabinetit të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Si përfundim:

Titulli i Gjetjes Nr.3	<i>Në institucionin e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, nuk janë marrë masat për hartimin dhe miratimin e një Rregulloreje për Trajtimin e Ankesave⁶. Regjistri Analitik i Komunikimit të Brendshëm të Trajtimin të Ankesave është një dokument i regjistruar në excel, ku gjenerohen të dhëna për periudhën Janar 2020 - Korrik 2021, prej të cilave janë hartuar dhe publikuar raporte mujore vetëm për periudhën Tetor 2017 deri në muajin Nëntor 2020 .</i>
Situata	1. Kontrolli i Lartë i Shtetit konstaton se, nga MiSHMS, nuk janë marrë masat për hartimin dhe miratimin e një Rregulloreje për Trajtimin e Ankesave, si dokument udhëzues metodik për disiplinimin e procesit të regjistrimit, identifikimit, kategorizimit e shqyrtimit, procedurat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve dhe ri kërkimit të informacioneve shtesë, analizimit të ecurisë dhe mbledhjes së informacionit standard e të domosdoshëm për zgjidhjen e ankesave brenda afateve të miratuara, gjurmimin e ankesave,

⁶- Audituesit e KLSH nuk kanë rekomanduar hartimin e rregullores për trajtimin e ankesave, meqenëse, ky proces është rregulluar dhe disiplinuar nga ligji nr. 107/2021, datë 4.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	<p>ndjekjen dhe trajtimin e ankesave administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike, si dhe të zyrtarëve të tyre.</p> <p>2. Nga auditimi u konstatua se, Regjistri Analitik i Komunikimit të Brendshëm të Trajtimit të Ankesave është një dokument i regjistruar në <i>excel</i>, ku gjenerohen të dhëna për periudhën Janar 2020 - Korrik 2021, prej të cilave janë hartuar dhe publikuar raporte mujore deri në muajin Nëntor 2020. Nga ana e MiSHMS mungon një regjistër fizik (hardcopy), për të regjistruar, dokumentuar dhe ndjekur ankesat, sipas përcaktimeve të Rregullores së Brendshëm të funksionimit të MiSHMS.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">• VKM nr. 511, datë 13.09.2017 për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes”,• VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes,• ligji nr. 107/2021, datë 4.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”.
Ndikimi/Efekti:	Në disiplinimin e procedurave të institucionit shtetëror
Shkaku:	Mosveprimi i strukturave përgjegjëse.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	<p>Të merren masat për ndjekjen në vijimësi të backlogut të ankesave të sipërmarrjes private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe të huaj, në proces shqyrtimi, të cilat janë të mbartura prej vitesh dhe shtrihen brenda juridiksionit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, si dhe atyre ankesave që janë dërguar për kompetencë në vijimësi nga ana e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, kur MiSHMS është institucioni përgjegjës për monitorimin, ndjekjen dhe trajtimin e çështjeve të regjistruara në seksionet e platformës “<i>Me ty për Shqipërinë që duam</i>”.</p> <p>Për sa sipër, në kuadër të promovimit të transparencës dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të sipërmarrjes, të respektohen afatet dhe procedura e parashikuar në legjislacionin mbi bashkëqeverisjen, duke publikuar rregullisht raportet mujore mbi ecurinë e shqyrtimit të këtyre ankesave.</p>
Afati	Menjëherë e në vijimësi

Konstatim nr.5:

Mungon gjurma e miratuar e auditimit, të ankesave, në kundërshtim me përcaktime e nenit 4, pika 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, që përcakton se:

“Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË
SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.”

nenit 16, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, që përcakton se:

2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Nga ana e audituesve të autorizuar të KLSH janë evidentuar një stok ankesash me statusin “Proces Verifikimi” këto raste sipas muajve, pasqyruar në raportet e bëra publike nga ana e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, mirëpo mungojnë gjurmët e veprimeve administrative të praktikave shkresore, me veprimet përkatëse që ri kërkojnë adresimin dhe përshpejtojnë zgjidhjen dhe adresimin e problemit nuk janë evidentuar në vijim në tabelat mujore për efekt trajtimi, për të kuptuar nëse është finalizuar trajtimi i tyre. Kështu mund të përmendim këto situata të rezultuara nga auditimi me zgjedhje në periudha, bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga subjekti i auditimit:

Për sa sipër, nuk ka gjetur zbatim të plotë përcaktimet e pikës nr.4, të VKM nr. 511, date 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë së ministrit të shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes”, që përcakton se: *Me qëllim realizimin e veprimtarisë si mësipër, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes:*

- a) krijon platformën elektronike të ndërveprimit me sipërmarrjen për komunikimin dhe gjurmimin e ankesave të tyre;*
- b) krijon regjistrin e komunikimit të brendshëm të trajtimit të ankesave, përmes së cilit monitoron procesin ndërinstitucional dhe i raporton Kryeministrit çdo fillim muaji;*
- c) krijon rregulloren e procedurës së brendshme, e cila detajon procedurën e:
 - i) regjistrimit dhe të pranimit të ankesave, sipas kriterëve të përcaktuara në rregullore;*
 - ii) komunikimit dhe të investigimit të çështjeve të pranuar me institucionet e lidhura publike;*
 - iii) mbledhjes së evidencave dhe të informacionit të nevojshëm nga institucionet e pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike dhe /ose personave të tretë;*
 - iv) komunikimit midis institucioneve publike dhe të sipërmarrjes që ka kryer ankimimin; sidhe*
 - v) raportimit dhe publikimit të statusit të ankesave të trajtuara.**

Në lidhje me sa më sipër, me anë të shkresës nr. 4979/10, datë 04.01.202, të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, protokolluar në KLSH me nr. 792/6 prot., datë 09.01.2023, është theksuar si më poshtë:

Qëndrimi i subjektit, MiSHMS:

Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, **do të depozitojë tek titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, brenda muajit shkurt të vitit 2023.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka vlerësuar faktin se, MiSHMS ka filluar procesin e ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të dërguara në projekt-raportin e auditimit të përputhshmërisë, të ushtruar në këtë institucion. Duke qenë se përgjigjja e MiSHMS nuk sjell argumente të tjera ligjore përveç atyre të shqyrtuara dhe diskutuara më parë, kërkohet zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti përfundimtar të auditimit.

Titulli i Gjetjes Nr.4	<ul style="list-style-type: none">✓ <i>Në institucionin e MiSHMS për periudhën objekt auditimi nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurma auditimit për proceset kryesore, në kundërshtim me përcaktime e nenit 4, pika 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".</i>✓ <i>Po kështu, nga ana e MiSHMS nuk është hartuar dhe depozituar tek nëpunësi i parë autorizues në MFE sipas afateve ligjore në fuqi për periudhe e audituar , Pyetësori i Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti Vjetor përkatës mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të kësaj njësie publike të qeverisjes qendrore.</i>
Situata	Për periudhën objekt analize e vlerësimi (nga data 10.9.2017 deri më datën e mbajtjes së raportit të auditimit), MiSHMS ka vijuar veprimtarinë pa disponuar një gjurmë të miratuar të auditimit.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">• neni 4, pika 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010,"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin;• neni 16, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010,"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;• pikës nr.4, të VKM nr. 511, date 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës se përgjegjësisë se ministrit të shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes";• neni 18, "Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm", pika 1, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar: "Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës 1, të nenit 3, të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji".
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e një gjurmës së auditimit bëhet pengesë për vlerësimin e jashtëm të këtyre proceseve nga ana e audituesve të jashtëm të pavarur. Moskoherenca midis zhvillimeve të MiSHMS dhe reflektimit në dokumentet kryesore apo dhe mos raportim në MFE.
Shkaku:	Mos marrja e masave nga ana e menaxhimit për miratimin dhe arkivimin e



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	gjurmës së auditimit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	<p>A. Të merren masat nga ana e institucionit të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, për përgatitjen dhe miratimin e gjurmës së auditimit të proceseve kryesore (të tilla si, skema e përfitimit/ financimi i granteve për thirrjet e startupeve dhe lehtësuesve, promovimin e sipërmarrjes, ndjekjen e ankesave të subjekteve të biznesit me statusin në “Proces Verifikimi “që janë brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, koordinimin me hallkat e tjera të administratës dhe rolin në kuadër të sekretariatit të KEK, etj.).</p> <p>B. Nga ana e MiSHMS të merren masat për hartimin dhe depozitimin tek nëpunësi i parë autorizues, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit pasardhës, të Pyetësorit të Vetëvlerësimit, Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshme të kësaj njësie publike, për vitin e mëparshëm.</p>
Afati	a. Menjëherë e në vijimësi b. Në vijimësi

Një strukturë tjetër, në varësi të MSHMS, me një rol kyç në procesin e organizimit dhe veprimin të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është **Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar (KEK)**, e përcaktuar kjo si strukture buxhetore publike, në VKM nr. 281, datë 16.05.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe përcaktimin e Ministrisë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 57/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KEK “, i ndryshuar.

Sipas përcaktimeve të pikës nr. 2 të këtij Vendimi, MSHMS është ministri përgjegjës për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 57/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KEK “, i ndryshuar.

Grupi i audituesve të autorizuar evidentoi nismat ligjore të propozuara nga ana e MiSHMS për periudhën objekt auditimi dhe rezultoi:

Për sa i përket nismave ligjore të dy ish Ministrave znj.Q dhe Z.Sh, njësia e audituar ka raportuar se, ato kanë qenë të propozuara nëpërmjet konsultimeve dhe tryezave me palë të interesuara në rolin e ndërmjetësuesit dhe jo në formën e propozimeve ligjore zyrtare.

Për sa i përket nismave ligjore të iniciuara nga ana e ministrit znj.B, referohen:

Projektligji për Mbështetjen dhe Zhvillimin e StartUp-eve, i cili i është:

- propozuar Këshillit të Ministrave me datë 17/12/2021 dhe
- miratuar nga Këshilli i Ministrave me datën 20/12/2021;
- miratuar nga Parlamenti me datën 10/03/2022, Ligji 25/2022 "Për mbështetjen dhe zhvillimin e Startup-eve".

Gjithashtu, janë miratuar 5 akte nënligjore (VKM) në funksion të zbatimit të ligjit të datë 11/05/2022



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

II. Auditimi mbi mbështetjen për zhvillimin dhe monitorimin e e startup-eve dhe ekosistemit në zbatim të ligjit nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e stratup-eve”.

- **Këshilli i Stratup-eve në nxitjen e zhvillimit të startup-eve si organ kolegjal.**

Baza ligjore për auditimin sipas pikës nr. 2 të Programit të auditimit 792/2 datë 19.09.2022 “Auditim përputhshmërie mbi veprimtarinë e MiSHMS”:

- *Ligji nr. 25, datë 10.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”,*
- *VKM nr. 314, datë 11.5.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, funksionimin, përbërjen, kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes, si dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të startup-eve”,*
- *VKM nr. 466, datë 30.7.2021 “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve, 2021–2027, dhe të planit të saj të veprimit”, etj.*

U kërkua vënia në dispozicion nga subjekti i audituar i dokumentacionit shoqëruar të mbledhjeve të Këshillit të startup-eve, shkresat e caktimit të anëtarëve të Këshillit, etj. .

Gjatë auditimit u konstatua se termi “startup” dhe trajtimi financiar i tyre nuk ka lindur me ligjin 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”. Kështu sipas VKM nr. 210, datë 20.04.2018 “Për krijimin e fondit në mbështetjen e sipërmarrjeve të reja startup”, si dhe VKM nr. 466, datë 30.7.2021 “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve, 2021–2027, dhe të planit të saj të veprimit”, Pjesa I, “Konteksti strategjik” ka si nënpikë të saj “Veprimtarinë e startup-eve dhe inovacionit”, ku është citimi se “Disa agjenci janë përfshirë në zbatimin e politikave inovative, si AIDA-n dhe Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHI). Ndërkohë që *AIDA fokusohet në pjesën e biznesit, AKKSHI fokusohet në institucionet kërkimore*, duke lehtësuar shkëmbimin e njohurive dhe mbështetjen financiare për projekte kërkimi. Me përpjekje të përbashkëta dhe nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është hartuar një kuadër ligjor për startup-et inovative, konstatohet se baza ligjore për startup-et është pasuruar me një ligj nr. 25/2022 dhe pesë Vendime të Këshillit të Ministrave. Sipas këtij kuadri ligjor të ri organet përgjegjëse për mbështetjen, nxitjen dhe zhvillimin e startup-eve janë MiSHMS, Këshilli i startup-eve dhe ministri/ institucione të tjera publike të përcaktuara në VKM përkatëse.

Sipas Ligjit nr. 25/2022, Këshilli i Startup-eve është një organ kolegjal i cili jep kontribut në nxitjen e zhvillimit të startup-eve, Kryetar i të cilit është Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Rregullat e hollësishme për përbërjen e Këshillit, kriteret, procedurën e përzgjedhjes dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit, kompetencat, organizimin e funksionimin e Këshillit përcaktohen në VKM Nr. 314, datë 11.5.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, funksionimin, përbërjen, kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes, si dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të startup-eve”. Sipas VKM Nr. 314, Këshilli i startup-eve kryesohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të tjerë të zgjedhur nga institucione të lidhura me shërbimet e ofruara për biznesin dhe startup-et me mandat për një periudhë 1-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje: a) një anëtar i caktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, i cili mbulon fushën e sipërmarrjes; b) një anëtar i caktuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), i cili mbulon fushën e sipërmarrjes dhe inovacionit; c) një anëtar i caktuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, i cili mbulon fushën e startup-eve dhe inovacionit (AKSHI); ç) një anëtar i caktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Pronësisë Industriale (DPPI); d) një anëtar i caktuar nga G.AI, i cili mbulon zhvillimin dhe promovimin e startup-eve dhe të ekosistemit.

Në vijim të VKM, shkresave të nisura nga MiSHMS dhe komunikimeve elektronike me institucionet e mësipërme janë caktuar si anëtarë të Këshillit të Startup-eve si më poshtë:

- Z. B.K, Zv/ Ministër i Financave dhe Ekonomisë;
- Z. S.N, Drejtor Ekzekutiv i AIDA-s;
- Znj. R.K, Drejtor i Inovacionit pranë AKSHI;
- Znj. R.B, Drejtor i Përgjithshëm i DPPI;
- Z. P.F, EU for Innovation G.AI;

Për mbledhjen e parë të Këshillit të Startup-eve të zhvilluar në datën 07.06.2022 janë mbajtur minutat e takimit. Në këtë mbledhje përveç pjesëtarëve të Këshillit të Startup-eve kanë qenë pranishëm dhe Z. E.D, EU for Innovation- Ambasada e Suedisë, si i ftuar nga ekosistemi dhe dy përfaqësues të Sekretariatit Teknik të Këshillit të startup-eve. Anëtarët kanë shprehur rëndësinë që tashmë startup-et kanë një bazë ligjore. Drejtori i Inovacionit pranë AKSHI ka përshkruar se pranë hub-it shtetëror TechSpace, i cili menaxhohet nga ky institucion, rezultojnë mbi 1000 të rinj të regjistruar si dhe rreth 100 ide startup-esh. Drejtori ekzekutiv i AIDA ka theksuar se mbështetja me grante për startup-et nga AIDA nuk është realizuar që prej vitit 2019 dhe tani është pothuajse gati një VKM për grant të radhës. Nga Ministri i shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është prezantuar rrugëtimi deri në hapjen e thirrjes dhe fushave që mbështeten me grant. Në mbledhje, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, është diskutuar mbi një rakordim të vazhdueshëm midis MiSHMS dhe AIDA në lidhje me disbursimit e grantit dhe është propozuar takimi i mundshëm gjatë muajt shtator 2022 dhe dhjetor 2022.

Gjatë auditimit të dokumentacionit shoqërues të mbledhjes së Këshillit të Startup-eve konstatohet se nuk janë dhënë mendime të tjera mbi përmirësimin e politikës ekzistuese të startup-eve, duke qenë kuadri ligjor relativisht i ri. Minutat e takimit janë mbajtur përpara mbylljes së thirrjes së parë për startup-e dhe përpara nisjes së punës së Komisionit të Vlerësimit të aplikimeve për startup-e dhe lehtësues.

III. Auditimi mbi procedurën e thirrjes për aplikime për përfitimin e granteve nga ana e startup-eve dhe lehtësuesit e startup-eve nëpërmjet publikimit në shërbimin startup one-stop-shop në faqen zyrtare.

- **Komisioni i vlerësimit në shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve të mbërritura për startup-et.**

Baza ligjore për auditimin sipas pikës nr. 3 të Programit të auditimit 792/2 datë 19.09.2022 “Auditim përputhshmërie mbi veprimtarinë e MiSHMS”:

- Ligji nr. 25, datë 10.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”,
- VKM 313, datë 11.5.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërbimit të anëtarëve të tij”,
- VKM 311, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme të veprimtarinë dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit startup one stop shop, si dhe shërbimeve të tjera për të cilat aplikohet tarifa zero për mbështetjen e startup-eve”,
- VKM 312, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për përmbajtjen e regjistrit të startup-eve dhe lehtësuesve, mënyrën e funksionimit dhe ndërlidhjen e tij me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

portalin qeveritar e-albania, si dhe për dokumentet elektronike pasaporta e startup-eve dhe pasaporta e lehtësuesve”,

- VKM 315, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e kërkesave dhe kritereve që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve, si dhe miratimin e procedurave dhe afatet e thirrjes për përfitim të granteve dhe masave mbështetëse”,
- Rregullore për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup -eve që aplikojnë për masa mbështetëse,
- VKM nr. 314, datë 11.5.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, funksionimin, përbërjen, kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes, si dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të startup-eve”, etj.

U kërkua vënia në dispozicion e shkresave për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të aplikimeve, dokumentacionit të mbledhjeve të Komisionit të Vlerësimit të aplikimeve, regjistrin të pasaportave të startup-it dhe lehtësuesve, Vendimet e Komisionit të Vlerësimit, dokumentacionit shoqërues i aplikimeve për startup dhe lehtësues të startup-eve, etj.

Sipas VKM 313, datë 11.5.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”, Komisioni i Vlerësimit do të vlerësojë dhënien e Granteve për Mbështetjen e Startup-eve dhe shërben si organ vlerësues për kërkesat e startup-eve dhe lehtësuesve. Komisioni i vlerësimit të dhënies së grantit për mbështetjen e start up-eve dhe lehtësuesve sipas VKM së mësipërme kryesohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe përbëhet nga 4 (katër) anëtarë të tjerë të zgjedhur me mandat për periudhën e disbursimit të grantit maj–dhjetor 2022, me të drejtë rizgjedhjeje: a) një anëtar i caktuar nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen; b) një anëtar i caktuar nga ministri përgjegjës për rininë dhe fëmijët; c) një anëtar i caktuar nga Fondacioni AADF, nga sektori i sipërmarrjes që mbulon tematikën e start up-eve dhe ekosistemit; ç) një anëtar ekspert nga ekosistemi i startup-eve.

Sipas shkresës nr. 2810, datë 13.05.2022 “Mbi përcaktimin e përfaqësuesit në Komisionin e Vlerësimit të Dhënies së granteve për mbështetjen e startup-eve” Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka përcaktuar, brenda afatit 5 ditor të përcaktuar në VKM, përfaqësuesin e tij në këtë Komision Znj. A.T, e cila mban pozicionin e Drejtorit të Kabinetit në atë ministri. Me shkresën nr. 22/049, datë 13.05.2022, AADF ka përcaktuar anëtarin e tij përfaqësues në Komision Zj. E.R, me pozicion menaxhere projektsh në Programin e Sipërmarrjes në AADF. Me urdhrin nr. 6, prot 2958, datë 20.05.2022 “Për emërimin e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit”, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka emëruar si anëtar Znj. A.B, në pozicionin e Këshilltarit të Ministrisë të Shtetit.

Për përcaktimin e anëtarit ekspert nga ekosistemi i startup-eve sipas VKM nr. 313, datë 11.05.2022 është kryer një proces konkurrimi pas shpalljes së thirrjes në faqen zyrtare të ministrisë. Sipas shkresës nr. 2843, date 16.05.2022 “Termet e referencës “Për aplikim për ekspert të Komisionit të Vlerësimit nga ekosistemi i startup-eve” procesi i aplikimit është kryer nëpërmjet adresës elektronike info@sipermarrja.gov.al. Afati i aplikimit ka nisur më 16.05.2022 dhe ka përfunduar më 26.05.2022. Në shkresën nr. 2843/1, datë 16.05.2022 janë përcaktuar kriteret e vlerësimit dhe përzgjedhjes së ekspertit sipas një table pikëzimi të ndarë në 6 kategori me një total prej 100 pikësh.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Me Urdhrin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes nr. 8, prot 3107, datë 30.05.2022 është ngritur komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e ekspertëve nga ekosistemi i startup-eve me këtë përbërje Znj. M.M, Këshilltare e Ministrit të Shtetit, Znj. M.G, Drejtor Kabineti dhe Znj. P.S përfaqësuese nga Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar (STKEK). Komisioni ka renditur listën e aplikantëve fitues në Vendimin nr. 1, prot 2843/2, datë 31.05.2022 “Për përzgjedhjen e ekspertit të ekosistemit të startup-eve” dhe ka përzgjedhur aplikantin fitues Z. M.A dhe të renditurin e dytë në listë Z. E.M, si zëvendësuesin e tij në rast mungese në mbledhjet e Komisionit të Vlerësimit të startup-eve dhe lehtësuesve, nga një listë prej 3 aplikimesh në total. Me fituesin e renditur të parin është lidhur kontrata me nr. 2843/3, date 10.06.2022.

Komisioni i vlerësimit është mbledhur brenda 5 ditëve nga mbyllja e thirrjes sipas përshkrimit në procesverbalin nr. 3805, datë 29.06.2022.

Në zbatim të pikës nr. 3 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni dhe rezultoi si më poshtë:

Pas pasurimit të bazës ligjore me ligjin nr. 25/2022 dhe pesë VKM për startup-et, të hyra në fuqi prej Marsit 2022 deri më Maj 2022, MiSHMS është bërë ministria përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit të mbështetjes financiare të sipërmarrjeve inovatore në fusha prioritare. Startup-et dhe lehtësuesit, si aktorët kryesorë të këtij përfitimi financiar, pas një vetë deklarimi dhe një projekti inovator mund të përfitojnë mbështetje financiare me fonde buxhetore në formën e granteve, si dhe nga burime të tjera financimi, nëse plotësojnë kriteret dhe rezultojnë fitues pas një procesi konkurrues. Në funksion të realizimit të këtij objekti në faqen zyrtare të MiSHMS postuar më 16.05.2022, është bërë njoftimi i hapjes së Thirrjes së parë për aplikim nga startupe dhe lehtësues me vlefshmëri prej 16 Majit 2022 deri më 5 Qershor 2022.

Konstatim nr. 1/a): Gjatë auditimit u konstatua se në faqen zyrtare të MiSHMS të postuar më 20.05.2022 është publikuar se për startup-et do të shpërndahen 10 milionë euro, për mbështetjen e të rinjve në botën e sipërmarrjes⁷. Nga komunikimi me subjektin e audituar konstatohet se mbështetja e mësipërme financiare përbën një angazhim të Qeverisë së Shqipërisë për tu shpërndarë në 4 thirrje për startup-e në shumë të barabartë (2.5 milion euro secili), por pa na u vënë në dispozicion ndonjë dokumentacion tjetër mbështetës mbi planifikimin financiar të këtij angazhimi. Përsa i përket pjesës që i takon për tu shpërndarë me Thirrjen e parë përgjatë vitit 2022, konform VKM nr. 375, datë 1.6.2022, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për zbatimin e ligjit nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” konstatohet se fondet e miratuara për shpërndarje të grantit do të disbursohen nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe i përkasin fondit rezervë të buxhetit të shtetit për vitin 2022 në shumën 300 milionë lekë.

Përdorimi i fondit rezervë të buxhetit të shtetit për shuma të paparashikuara justifikohet deri diku me mungesën kohore të planifikimit buxhetor sipas afateve klasike dhe standarte, por në rastin e mungesës së një situatë emergjente sic është mbështetja financiare e ideve inovatore dhe prioritare, bie ndesh me përmbajtjen e Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

Pika 15 e Nenit 3, ku përcaktohet se:

“Fondi rezervë” është fondi, që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit”;

⁷- <https://sipermarria.gov.al/wp-content/themes/ministria/img/bfnewfooter.jpg>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Nenit 45 “Kërkesat për fonde shtesë”, të këtij ligji:

Nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes qendrore paraqesin pranë nëpunësit të parë autorizues kërkesë për fonde shtesë, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në kohën e përgatitjes së buxhetit dhe që nuk mund të shtyhen për vitin buxhetor pasardhës.”

Kreut II “Sistemi buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 5:

“Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit”.

si dhe paragrafin nr. 90, “Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit dhe Fondi i Kontingjencës”, të Kreut II “Procedurat standarde të shpërndarjes dhe rishpërndarjës së fondeve të buxhetit vjetor”, të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që përcakton se:

Procedura për përdorimin e këtij fondi kalon në këto faza:

a). Ministrinë e linjës paraqesin tek Ministri përgjegjës për Financat një projektvendim ku kërkohet shtesë fondi në buxhetin e vitit nga përdorimi i fondit rezervë, duke përcaktuar edhe llojin e shpenzimeve. Relacioni shoqëruar i projektvendimit duhet të përmbajë informacionin si më poshtë:

iii. *Të argumentojë pamundësinë e planifikimit të këtij shpenzimi gjatë fazës së përgatitjes së projektbuxhetit;*

iv. *Të argumentojë pamundësinë e përballimit të këtij shpenzimi nëpërmjet rialokimit të fondeve brenda sistemit nëpërmjet paraqitjes së analizës së realizimit të buxhetit për periudhën raportuese.*

MiSHMS duke qenë një ministri pa portofol dhe me numër të vogël punonjësish (pesë punonjës), nuk ka në strukturën e saj një punonjës që të merret me funksionin e financës, megjithatë për kryerjen e planifikimit buxhetor duhet të ketë një bashkëpunim me Kryeministrinë nga e cila ka varësi, konform parashikimeve të pikës nr. 27, të VKM Nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, që shpreh se:

“Në rastet e institucioneve me më pak së 15 (pesëmbëdhjetë) pozicione pune, funksioni i lidhur me financat e institucionit mund të kryhet nga institucioni qendror nga i cili varet institucioni apo institucioni qendror përcakton së nga kush do të kryhet funksioni.”

1/b). Gjatë fazave të përgatitjes së projekt ligjit për startup-et, miratimit të ligjit përkatës, por dhe deri në fund të periudhës së auditimit konstatohet se nuk janë paraqitur nga ana e MiSHMS kërkesa buxhetore për fonde të lidhura me mbështetjen e inovacionit. Nga udhëzimi plotësues nr. 22, datë 8.07.2022 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025”, Pika 10. Afatet për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, b) “Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 për Fazën strategjike, në të cilën përfshihen edhe propozimet për investimet publike, është deri më datë 2 Maj 2022 dhe c) Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 për Fazën Teknike është deri më 1 Shtator 2022 ” dhe duke mos patur kërkesa buxhetore të përgatitura nga MiSHMS në bashkëpunim apo jo me Drejtorinë përgjegjëse për planifikimin dhe financat në institucionin e Kryeministrisë, vijmë në përfundimin se fondet për thirrjet e tjera për grante për vitin 2023, nëse do të ndiqen afatet e parashikuara dhe disiplina standarde e planifikimit buxhetor, mbart riskun e mos përfshirjes në PBA e vitit 2023-2025 si dhe në buxhetin e vitit 2023.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

1/c). Megjithëse gjatë auditimit konstatohet se shuma e vënë në dispozicion për thirrjen e parë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit ka qenë 300 milionë lekë, në përfundim të thirrjes së parë deri në fund të periudhës së auditimit datë 30.06.2022, rezulton se shuma që është miratuar për financim përbëhet nga 260,938,448 lekë, e cila është 39,061,552 lekë ose 13% më pak se shuma e parashikuar për tu shpërndarë gjatë kësaj thirrjeje. Fakti i mësipërm sjell një mosrealizim të fondit rezervë të alokuar për mbështetjen e startup-ve në masën 13%.

Mbështetjen me grant mund ta përfitojnë startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve të vetëdeklaruar në regjistrin elektronik, të cilët pajisen me pasaportën e startup-it apo lehtësuesit. Kërkesa për mbështetje me grant është kryer online, nëpërmjet faqes zyrtare dhe adresës elektronike startup@sipermarrja.gov.al të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MiSHMS). Gjatë auditimit u konstatua ekzistenca e dy faqeve zyrtare për MiSHMS, përkatësisht www.sipermarrjaime.gov.al dhe www.sipermarrja.gov.al. Aplikimi i startup-eve dhe lehtësuesve dhe gjithë hallkat e procesit janë publikuar në faqen e ministrisë sipermarrja.gov.al.

Në lidhje me sa më sipër, me anë të shkresës nr. 4979/10, datë 04.01.202, të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, protokolluar në KLSH me nr. 792/6 prot., datë 09.01.2023, është theksuar si më poshtë:

Qëndrimi i subjektit, MiSHMS:

Parimisht *është e drejtë gjetja e rekomandimit*, por vlerësojmë të evidentojmë sërish se rrethanat e përdorimit të fondit rezervë për financim të granteve për startup-e, ishin të tilla që legjitimonin tërësisht veprimin, përdorimin e fondit rezervë, pasi këto fonde ishin të pamundura të parashikohen në fazën e përgatitjes së buxhetit në vitin 2021 për 2022. Kjo sepse ligji nr. 25/2022, është miratuar në 10/03/2022. Pra miratimi i fondeve buxhetore për grantet është kryer tërësisht në përputhje me rrethanat e ligjit, gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera.

Evidentojmë sërish se edhe për vitin 2023 ishte objektivisht e pamundur për të realizuar planifikimin buxhetor, pasi vijnë afatet e zbatimit e monitorimit të projekteve fituese në 2022. Për rrjedhojë vlerësimi i rezultateve të thirrjes së parë do të impaktojë hapjen ose jo të thirrjes së dytë pikërisht në 2023, kohën e hapjes së saj dhe përcaktimin e vlerës së këtyre fondeve etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Duke qenë se përgjigjja e MiSHMS nuk sjell argumente të tjera ligjore përveç atyre të shqyrtuara dhe diskutuara më parë, kërkohet zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti përfundimtar të auditimit.

Si përfundim:

Titulli i gjetjes nr. 5	<i>Parregullsi në procesin e planifikimit buxhetor; përdorim i fondit rezervë për mbështetjen e projekteve inovative.</i>
Situata	1/a) Gjatë auditimit u konstatua se në faqen zyrtare të MiSHMS të postuar më 20.05.2022 ⁸ është publikuar se për startup-et do të shpërndahen 10 milionë euro, për mbështetjen e të rinjve në botën e

⁸(<https://siperarrja.gov.al/10-mln-euro-grante-per-start-up-et-per-siperarrjesit-e-rinj-ministrja-bilali-ne-pa-protokoll/>)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	<p>sipërmarrjes. Mbështetja e mësipërme financiare përbën një angazhim të Qeverisë së Shqipërisë për tu shpërndarë në 4 thirrje për startup-e në shumë të barabartë (2.5 milion euro secili), por pa vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH ndonjë dokumentacion tjetër mbështetës mbi planifikimin financiar strategjik të tij.</p> <p>1/b) Fondet e miratuara për thirrjen e parë për mbështetjen financiare të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve konstatohet se i përkasin <i>fondit rezervë të buxhetit të shtetit për vitin 2022</i>, në shumën 300 milionë lekë, alokuar sipas VKM nr. 375, datë 1.6.2022, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për zbatimin e ligjit nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”.</p> <p>1/c) Megjithëse gjatë auditimit konstatohet se shuma e vënë në dispozicion për thirrjen e parë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit ka qenë 300 milionë lekë, në përfundim të thirrjes së parë deri në fund të periudhës së auditimit datë 30.06.2022 është miratuar për financim shuma 260,938,448 lekë, e cila është 39,061,552 lekë ose 13% më pak se shuma e parashikuar për tu shpërndarë gjatë kësaj thirrjeje. Deri në përfundim të auditimit në terren, u konstatua se janë shqyrtuar 16 ankimime, prej të cilave janë shpallur fitues dhe është miratuar dhënia e fondit për 6 startup-e të tjerë, miratuar me VKM nr. 618, datë 22.9.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr. 480, datë 13.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dhënies së granteve për startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve”, sipas listës aneksit bashkëlidhur. <i>Mënyra e përzgjedhjes dhe kualifikimit si fitues, i 6 startupeve që kanë paraqitur ankim, nuk është audituar nga KLSH pasi shtrihet jashtë periudhës së auditimit, megjithatë konstatohet se me shtimin e kësaj shume, vlera totale e miratuar në përfundim të thirrjes së parë të jetë 283,899,734 lekë ose 95% të fondit rezervë të alokuar, duke mos u realizuar ky fond në shumën 16,100,266 ose 5% të tij.</i></p> <p>1/d) Gjatë fazave të përgatitjes së projekt ligjit për startup-et, miratimit të ligjit përkatës, por dhe deri në fund të periudhës së auditimit konstatohet se nuk janë paraqitur nga ana e MiSHMS kërkesa buxhetore për fonde të lidhura me mbështetjen e inovacionit. Duke mos patur kërkesa buxhetore të përgatitura nga MiSHMS në bashkëpunim me Njësinë e Buxhetit dhe Administrimit në Kryeministri nga e cila ka varësi, fondet për thirrjet për grante për vitin 2023, nëse do të ndiqen disiplina standarde e planifikimit buxhetor, mbart riskun e mospërfshirjes në PBA e vitit 2023-2025 si dhe në buxhetin e vitit 2023.</p>
Kriteri	<p>Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Neni 3, Pika 15, Neni 5.</p> <p>Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Pika 90.</p> <p>Udhëzimi plotësues nr. 22, datë 8.07.2022 “Për përgatitjen e PBA 2023-</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	2025”, Pika 10. Afatet për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, b) dhe c).
Ndikimi/Efekti	Përdorim i fondit rezervë në rast të mungesës së emergjencës dhe mungesë planifikimi financiar për periudhat e mëvonshme financiare.
Shkaku	Mosrespektim i disiplinës buxhetore
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	<p>1.Të merren masat nga ana e Ministrit të Shtetit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes, që, në përputhje me përcaktimet e nenit 7, gjerat “c” dhe “ç”, të ligjit nr. 25/2022 , datë 10.3.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, të koordinohen veprimet me ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë për planifikimin buxhetor të fondeve të startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta sipas kërkesave standarde të planifikimit buxhetor, me qëllimin e shmangies së praktikës së deritanishme të përdorimit të fondit rezervë për financimin e shpenzimeve të parashikuara në programin qeveritar të miratuar nga Kuvendi.</p> <p>2. Në kushtet që, MiSHMS si një ministri pa portofol dhe me numër të reduktuar kapacitetesh (pesë punonjës), nuk ka në strukturë një funksion të dedikuar për financën, për kryerjen e planifikimit buxhetor të bashkëpunohet ngushtësisht me Kryeministrinë, konform parashikimeve të pikës nr. 27, të VKM Nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm” dhe mbi këtë bazë ti propozohet Këshillit të Ministrave miratimi i fondeve buxhetore për grantet dhe format e tjera të mbështetjes së startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.</p>

Konstatim nr. 2/a): Gjatë auditimit nuk u konstatua prioriteti bazë mbi të cilët do të hapet thirrja për grant. Kështu nuk u konstatua fokusimi i projekteve aplikuese të thirrjes së parë në një prioritet specifik si dhe një plan strategjik për thirrjet e radhës në lidhje me prioritetin që duhet të kenë projektet aplikuese për grant. Ligji 25/2022 përcakton prioritet e përgjithshme që duhet të plotësojnë projektet konkurruese në Nenin 14 “Mbështetja e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse ”Pika 3:

“Thirrja për aplikime për përfitimin e granteve dhe të masave mbështetëse përmban kërkesat dhe kriteret që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve, procedurat dhe afatet respektive, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, duke marrë parasysh prioritetet e përgjithshme si më poshtë: a) mbështetja e inovacionit në fusha prioritare për zhvillimin e vendit; b) mbështetja e iniciativave që kanë impakt pozitiv mjedisor; c) fuqizimi i të rinjve; ç) fuqizimi i vajzave dhe grave sipërmarrëse; d) fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social; dh) prioritetet e tjera, sipas urdhrit të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen”.

Mungesa e përcaktimit të thirrjeve për grant sipas prioritetit krijon riskun e kryerjes së një procesi jo të adresuar dhe për financim me grant të projekteve të ndryshme nga i njëjti aplikant brenda të njëjtës thirrje.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Në lidhje me sa më sipër, me anë të shkresës nr. 4979/10, datë 04.01.202, të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, protokolluar në KLSH me nr. 792/6 prot., datë 09.01.2023, është theksuar se si më poshtë:

Qëndrimi i subjektit: Ju bëjmë me dije se MiSHMS ka qenë intensivisht e përfshirë në hartimin e Ligjit nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” dhe ka drejtuar e ndjekur proceset vijuese për hartimin e akteve nënligjore e rregullative. Mbi bazën e këtij kuadri ligjor MiSHMS ka drejtuar funksionimin e skemës së dhënies së granteve dhe monitorimin e zbatimit të projekteve fituese. Gjithashtu institucioni ka vijuar aktivitetin për promovimin e nismave në ekosistem dhe zhvillimin e politikave shtetërore për sipërmarrjen. Padyshim që kjo veprimtari intensive ka patur objektiva të matshëm e të realizuar mbi bazën e një programimi dhe metodologjie.

Përfundimi me sukses i thirrjes së parë për masat mbështetëse për startup-et dhe lehtësuesit si dhe objektivave të Qeverisë për mbështetje e lehtësim të sipërmarrjes në rrethanat e krizës globale të çmimeve e tregjeve ishte prioritet por përpos kësaj jemi në proces përmirësimi të dokumenteve të punës e strategjik të veprimtarisë së institucionit në nenin 14 pika 3dh) e Ligjit, si dhe në pikën 1dh) të VKM përcaktohen si fusha për dhënie grante edhe prioritete të tjera, sipas urdhrorit të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Realizimi i thirrjes së parë dhe analiza e hollësishme që do kryejmë në përfundim të monitorimit të projekteve fituese përbën një bazë efikase për të prioritarizuar edhe më tej fushat e mbështetjes, siç edhe rekomandohet sipas projekt raportit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka vlerësuar se, MiSHMS ka programuar masat për veprime aktive korrigjuese në vijimësi, referuar rekomandimeve të auditimit të KLSH. Duke qenë se përgjigjja e MiSHMS nuk sjell argumente të tjera ligjore përveç atyre të pashqyrtuara dhe diskutuara më parë, kërkohet zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti.

Si përfundim,

Titulli i gjetjes nr. 6	<i>Mungesë prioritetesh për thirrjen e parë për grant</i>
Situata	Megjithëse sipas përcaktimit në Pikën 3 Nenit 14 të Ligjit 25/2022 thirrjet për grant do të hapen sipas prioritete të përgjithshme që duhet të plotësojnë projektet konkurruese, gjatë auditimit nuk u konstatua shpallja e thirrjes së parë të mbështetjes me grant sipas një prioriteti specifik. Veprimi i mësipërm sjell riskun e krijimit të një procesi të pa adresuar të mbështetjes me grant.
Kriteri	Strategjia e Funksionimi të MiSHMS
Ndikimi/Efekti	Mungesë e reflektimit në strategji të prioriteteve të thirrjeve për grant.
Shkaku	Mungesë përditësimi i planit strategjik të MiSHMS.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	Në kuadër të rishikimit të strategjisë MiSHMS të marrë masa mbi hartimin dhe reflektimin e një plani në lidhje me prioritetin përkatës së çdo thirrjeje për grant në funksion të krijimit të një procesi të adresuar të mbështetjes me grant.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË
SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

2/b): Komisioni i vlerësimit të mbështetjes me grant i cili ka në fokus vlerësimin e kërkesave nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve kryesohet nga Ministri i shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, konform Pikës 4, Neni 14 dhe Pikës 2 të Neni 8 të Ligjit nr. 25, datë 25.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” Neni 14 “Mbështetja e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse”, Pika 4 që shpreh se:

“Me qëllim vlerësimin e kërkesave nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve ngrihet *komisioni i vlerësimit, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen*”.

si dhe Neni 8 “Këshilli i Startup-eve”, Pika 2, ku thuhet se,

“*Kryetar i Këshillit është ministri përgjegjës për sipërmarrjen*”.

Këshillit të startup-eve si organ kolegjal ka kompetenca si dhënien e kontributit për politikën ekzistuese nënkitjen e zhvillimit të startup-eve dhe ekosistemit si dhe identifikimin e analizimin e pengesave kryesore në zhvillimin e startup-eve, sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë sipas përcaktimeve në Kreu IV të VKM nr. 314, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, funksionimin, përbërjen, kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes, si dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të startup-eve”.

Komisioni i Vlerësimit të dhënies së granteve për mbështetjen e startup-eve është organ vlerësues për kërkesat e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve, kompetencat e të cilit përcaktohen në Kreu IV, të VKM nr.313, datë 11.5.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të vlerësimit, si dhe të kriterëve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”. Kompetencat e këtij Komisioni janë funksione administrative siç përcaktohen më poshtë konform Pikës 13, Kreu IV të VKM së mësipërme: Komisioni i vlerësimit ushtron këto detyra dhe kompetenca:

- a) *shqyrton dhe vlerëson të gjitha aplikimet e mbërritura nga startup-et dhe lehtësuesit;*
- b) *kërkon informacione ose dokumentacion shtesë nga aplikantët, atëherë kur gjykohet e domosdoshme për vendimmarrjen, nëpërmjet njësisë përgjegjëse për menaxhimin e grantit, pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen;*
- c) *plotëson raportin vlerësues për çdo aplikim dhe anëtarët e tij japin pikët individuale;*
- ç) *miraton nivelin e grantit për përfituesit startup ose lehtësues të start up-eve, bazuar në pikëzimin dhe vendimmarrjen e anëtarëve të komisionit të vlerësimit;*
- d) *merr në shqyrtim rastet problematike të aplikimit, me kërkesë të njësisë përgjegjëse pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.*

Kryesimi i Komisionit të Vlerësimit së dhënies së granteve për mbështetjen e startup-eve nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes bie në kundërshtim me Ligjin 90/ 2012 “Për funksionimin e administratës shtetërore”, Seksioni 1 Ministrisë, Neni 11 “Struktura e ministrisë”, Pika 1:

Ministria drejtohet nga ministri, *i cili drejton politikën shtetërore* për fushën që mbulon punën administrative dhe kontrolluese në institucion.

si dhe,

Ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika nr. 1:



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

“Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.”

8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

d) miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre.

si dhe Neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” ,Pika 4:

“Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:

f) ndarjen e përgjegjësive që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara.

Në lidhje me sa më sipër, me anë të shkresës nr. 4979/10, datë 04.01.202, të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, protokolluar në KLSH me nr. 792/6 prot., datë 09.01.2023, është theksuar se si më poshtë:

Qëndrimi i subjektit, MiSHMS: Për sa i përket rekomandimit 2.1 Kreu A “Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi” theksojmë sërish se vlerësojmë se përcaktimi me ligj i kryesimit të Komisionit të Vlerësimit nga Ministri i Shtetit, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 90/2012⁹ dhe ligjin nr. 10296/2010¹⁰, pasi:

-Organi kolegjal që kryesohet nuk është njësi publike e MiSHMS por strukturë ndër dikasteriale e madje në përbërje të saj ka edhe përfaqësues të OJF;

-MiSHMS nuk ka struktura organizative sekretar të përgjithshëm, drejtori, sektor e departamente; Ligji 25/2022, e aktet nënligjore në bazë të zbatimit të tij garantojnë sistem efektiv kontrolli dhe ndarje përgjegjësish administrative që lidhen me vendimmarrjen;

Qëndrimi i grupit të auditimit: Duke qenë se përgjigja e MiSHMS nuk sjell argumente të tjera ligjore përveç atyre të diskutuara, shqyrtuara më parë për të cilat janë dhënë qëndrimet në raport, prandaj kërkohet zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti.

⁹ Neni 11 pika 1 e ligjit 90/2012 për organizimin e funksionimit dhe administratës shtetërore: 1. Ministria drejtohet nga ministri, i cili drejton politikën shtetërore për fushën që mbulon punën administrative dhe kontrolluese në institucion. Ministria organizohet në këto struktura organizative hierarkike: a) sekretari i përgjithshëm; b) drejtoritë e përgjithshme; c) drejtoritë; ç) sektorët.

Departamentet janë struktura organizative të veçanta, të cilat mbulojnë një funksion të rëndësishëm vetëm të politikëbërjes dhe krijohen në rastet kur përmenden në një ligj të veçantë.

¹⁰ Neni 8 , pika 1 dhe 8/ae b të ligjit 10296 për menaxhimin financiar: 1. **Titullarët e njësive publike**, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave;

d) propozimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon ndryshe;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Si përfundim,

Titulli i gjetjes nr.7	<i>Nevoja për përmirësimin e Ligjit nr. 25/ 2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”.</i>
Situata	<p>Gjatë auditimit u konstatua se Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e sipërmarrjes është njëkohësisht dhe Kryetar i Këshillit të startup-eve dhe Kryetar i Komisionit të vlerësimit të dhënies se granteve për mbështetjen e startup-eve. Kështu sipas përcaktimeve të Pikës 2, Neni 8 të Ligjit nr. 25, datë 10.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” Ministri i Shtetit të Mbrojtjes së Sipërmarrjes është Kryetar i Këshillit të Startup-eve, si dhe sipas përcaktimeve të Pikës 4, Neni 14 të po këtij ligji Ministri i Shtetit të Mbrojtjes së Sipërmarrjes është dhe Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të dhënies se granteve për mbështetjen e startup-eve. Këshillit i startup-eve si organ kolegjal ka kompetenca si dhënien e kontributit për politikat ekzistuese në nxitjen e zhvillimit të startup-eve dhe ekosistemit, ndërsa Komisioni i Vlerësimit të dhënies se granteve për mbështetjen e startup-eve është organ vlerësues për kërkesat e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve përgjatë procesit konkurrues. Detyra e kryesimit të Komisionit të vlerësimit sipas kompetencave të përcaktuara në Pikën 13, Kreu IV të VKM 313, datë 11.5.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të vlerësimit, si dhe të kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij” përbën një funksion administrativ. Përbushja e detyrës së vlerësimit të fituesve apo jo fituesve pas një procesi konkurrues nga Ministri cenon linjën e raportimit të procesit të vlerësimit të projekteve inovative.</p>
Kriteri	<p>Ligjin 90/ 2012 “Për funksionimin e administratës shtetërore”, Seksioni 1 Ministrisë, Neni 11 “Struktura e ministrisë”, Pika 1. Ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II përgjegjshmëria menaxheriale” Neni 8 Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit Pika 1, Pika 8 a dhe d.</p>
Ndikimi/Efekti	Ndërthurje e funksionit politik me funksionin administrativ
Shkaku	Përcaktimi i Ligjit nr. 25/2022 Neni14, Pika 4 dhe Neni 8, Pika 2
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	<p>Të merren masat nga ana e Ministrit të Shtetit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes, që, të bëhen propozimet për përmirësimet e nevojshme të kuadrit ligjor në fuqi, përkatësisht të,</p> <ul style="list-style-type: none">- pikës 4, të Neni 14 “Mbështetja e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse”, të Ligjit nr. 25, datë 25.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, si dhe- pikës 3, të Kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 315, datë 11.05.2022, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të kritereve të procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”, <p>duke synuar përbushjen e qëllimeve, politikave dhe të objektivave të</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	këtij institucioni shtetëror me kërkesat e ligjit “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të kontrollit të brendshëm, që siguron ndarjen e duhur të përgjegjësiave administrative që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe linjat e raportimit.
--	--

2/c):Përbërja e Komisionit të Vlerësimit sipas specifikimeve të VKM 313, datë 11.5.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të kriterëve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërbimit të anëtarëve të tij”, kryesohet nga ministri përgjegjës për Sipërmarrjen dhe përbëhet nga 4 (katër) anëtarë të tjerë të zgjedhur me mandat për periudhën e disbursimit të grantit maj–dhjetor 2022, me të drejtë rizgjedhjeje: a) një anëtar i caktuar nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen; b) një anëtar i caktuar nga ministri përgjegjës për rininë dhe fëmijët; c) një anëtar i caktuar nga Fondacioni AADF, nga sektori i sipërmarrjes që mbulon tematikën e start up-eve dhe ekosistemit; ç) një anëtar ekspert nga ekosistemi i startup-eve.

VKM e mësipërme nuk bën specifikim në lidhje me formimin që duhet të kenë anëtarët e komisionit e cila merr rëndësi për faktin se secili anëtar i Komisionit bën vlerësimin e aplikimeve më vete.

Konstatim nr. 3: Duke iu referuar Kreut VI, të rregullores së grantit, miratuar me Urdhrin e Ministrisë nr. 3,(nr.2840prot), datë 16.05.2022 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup -eve që aplikojnë për masa mbështetëse”, Ministri përgjegjës për sipërmarrjen shpall thirrjen për aplikime nga ana e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve nëpërmjet publikimit në shërbimin startup one-stop-shop në faqen zyrtare. Në përmbushje të saj konstatohet shpallja e hapjes së thirrjes së parë për startup dhe lehtësues të startup-eve në faqen e web konform rregullores, me vlefshmëri prej datës 16 maj 2022 deri në datën 5 qershor 2022, shpallja e fituesve brenda datës 20 Qershor 2022 dhe lidhja e kontratave me ta brenda datës 15 Korrik 2022.

Gjatë auditimit konstatohet se këto data kanë qenë subjekt i vazhdueshëm i ndryshimit, pas njoftimeve përkatëse në faqen zyrtare të MiSHMS. Kështu në faqen zyrtare të ministrisë konstatohet njoftimi i MiSHMS me nr. 3223, datë 03.06.2022 “Njoftim mbi shtyrjen e shpalljes së fituesve”, i cili njofton aplikuesit se faza e thirrjes së parë është shtyrë deri më 10 Qershor 2022 dhe shpallja e fituesve është shtyrë brenda datës 27 Qershor 2022. Me njoftimin nr. 3697, datë 27.06.2022 “Njoftim mbi shtyrjen e afatit të shpalljes së fituesve”, shpallja e fituesve është shtyrë brenda datës 15 Korrik 2022 dhe firmosja e kontratave me fituesit është shtyrë brenda datës 30 Korrik 2022.

Në vijim të njoftimeve thirrja e parë është mbyllur më datë 10 Qershor 2022 konform njoftimit nr. 3223, datë 03.06.2022, dhe shpallja e fituesve sipas Vendimit nr. 1, prot 3806/1, “Mbi listën e fituesve të thirrjes së parë për startup-e dhe lehtësues të startup-eve” është bërë më datë 29.06.2022.

Procesi i vlerësimit të aplikimeve është kryer prej datave 15.06.2022 deri më 24.06.2022, në të cilat Komisioni i Vlerësimit të Mbështetjes me Grante Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve është mbledhur në 5 ditë për vlerësimin e 628 aplikimeve ose mesatarisht rreth 125 aplikimeve në ditë. Parashikimi i afatit 5 ditor në rregulloren e grantit për këtë pjesë të procesit është zbatuar, por ka sjellë vonesa në pjesët vijuese të tij.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Rregullorja e grantit duke qenë një rregullore e përgjithshme për të gjitha thirrjet nuk përmban një tabelë kohore me afate të standardizuara e gjithëpërfshirëse, të vlefshme për të gjitha thirrjet e mundshme për grant.

Konstatim nr. 4/a): Nga auditimi i procesit të vlerësimit të aplikimeve gjatë thirrjes së parë konstatohet se, Komisioni i Vlerësimit të Mbështetjes me Grant të Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve është mbledhur në datat 15.06.2022; 16.06.2022; 17.06.2022; 18.06.2022 dhe 24.06.2022 me pjesëmarrjen e plotë të anëtarëve dhe ka përpiluar një procesverbal të vetëm me nr. 3805 prot., datë 29.06.2022, duke mos dokumentuar procesin e plotë të diskutimeve dhe minutave të takimit që i përket secilës prej këtyre takimeve/ mbledhjeve, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Neni 16 “Procesverbali i mbledhjes”, Pika 1:

“Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçka je u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve”.

4/b). Gjatë procesit janë shqyrtuar 628 aplikime, nga të cilat 498 aplikime nga startup-e dhe 130 aplikime nga lehtësuesit e startup-eve. Pas vlerësimit të secilit aplikim, Komisioni i Vlerësimit të Mbështetjes me Grante Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve, ka vendosur në *Vendimin nr. 1, (nr.3806/1 prot), datë 29.06.2022* “Mbi shpalljen e fituesve të granteve financiare për mbështetjen e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve”, shpalljen fitues të aplikantëve të vlerësuar me 80 pikë e sipër, pa bërë një përshkrim mbi ç ‘bazë është marrë ky vendim, duke mos qenë i parashikuar në rregulloren e grantit. Si rezultat Komisioni ka shpallur fitues dhe miratuar nivelin e financimit për aplikimet e 23 startup-eve dhe 29 lehtësuesve startup-esh. Niveli total i grantit të miratuar është në shumën 260,938,448 lekë, i cili rezulton 39,061,552 lekë më pak kundrejt shumës së alokuar 300,000,000 lekë, duke deduktuar se fondi rezervë i akorduar do të përdoret në masën 87%. Shpallja e listës së fituesve dhe vlerës së financimit të miratuar është përmbledhur në procesverbalin nr. 3806 prot, datë 29.06.2022 “Për shpalljen e fituesve”. Procesverbalet janë firmosur rregullisht nga anëtarët pjesëmarrës të Komisionit të Vlerësimit të Mbështetjes me Grant.

Në *Vendimin nr. 2, (nr.3806/2 prot), datë 29.06.2022* “Për jo fituesit e granteve financiare për mbështetjen e startup-eve”, Komisioni i Vlerësimit të Mbështetjes me Grante Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve ka listuar aplikantët jo fitues të thirrjes së parë, e përbërë nga 475 startup-e dhe 101 lehtësues. E gjithë lista e jofituesve është cilësuar si e skualifikuar. Në vendim mungon një relacion shpjegues në lidhje me s kualifikimet, por Komisioni është mjaftuar vetëm me një renditje në formë tabelare të startupeve dhe lehtësuesve të skualifikuar, krahas numrit përkatës identifikues dhe pikëve të caktuara për çdo aplikant.

Përgjatë auditimit u konstatua se në përfundim të publikimit të listës së fituesve dhe jo fituesve në drejtim të MiSHMS janë adresuar 17 ankesa nga aplikantët e thirrjes së parë për të cilët është rishpallur fitues një listë prej 6 aplikimesh, të cilët nuk janë audituar nga ana e KLSH për shkak të shtrirjes së këtij procesi jashtë periudhës së miratuar të auditimit.

Në lidhje me sa më sipër, me anë të shkresës nr. 4979/10, datë 04.01.202, të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, protokolluar në KLSH me nr. 792/6 prot., datë 09.01.2023, është theksuar se si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Qëndrimi i subjektit, MiSHMS: Komisioni në bazë e zbatim të: VKM Nr. 313, datë 11.5.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e komisionit të vlerësimit, si dhe të kriterëve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”; Rregullores “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve që aplikojnë për masa mbështetëse”. Ka mbajtur e plotësuar raport vlerësues të miratuar paraprakisht sipas rregullores në formularin tip, për çdo çështje që është diskutuar ,pra çdo aplikim, janë evidentuar në çdo raport kësisoj anëtarët që morën pjesë dhe vendimmarrja e secilit, rezultati total i vlerësimeve, ndërsa forma e vlerësimit, përmes pikëzimit nga secili anëtar në formular, është e përcaktuar në rregullore gjithashtu. Në këtë mënyrë vlerësojmë se është i dokumentuar plotësisht gjithë procesi vendimmarrës, për çdo kriter të çdo aplikimi ka vlerësim individual nga secili anëtar komisioni, sipas përcaktimeve të ligjit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Duke qenë se përgjigja e MiSHMS nuk sjell argumente të tjera ligjore përveç atyre të pashqyrtuara dhe diskutuara më parë, kërkohet zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti.

Si përfundim,

Titulli i gjetjes nr.8	<i>Nevoja për përmirësim i rregullores së grantit</i>
Situata	<ul style="list-style-type: none">- Rregullorja e grantit nuk është e emërtuar si një rregullore specifike për thirrjen e pare, megjithëse në afatet e thirrjes rezultojnë të përfshijë vetëm vitin 2022 dhe nuk përmban një tabelë kohore me afate të standardizuara e gjithëpërfshirëse, të vlefshme për të gjitha thirrjet e mundshme për grant.- Megjithëse vlefshmëria, shpallja e fituesve dhe lidhja e kontratave të thirrjes së parë për grant janë shpallur në përmbushje të Rregullores “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup -eve që aplikojnë për masa mbështetëse”, gjatë auditimit konstatohet se datat e tyre kanë qenë subjekt i vazhdueshëm i ndryshimit, pas njoftimeve përkatëse në faqen zyrtare të MiSHMS, konkretisht me Njoftimin e MiSHMS Nr. 3223, datë 03.06.2022 dhe Njoftimin Nr. 3697, datë 27.06.2022 “Njoftim mbi shtyrjen e shpalljes së fituesve”.- Në përbërje të procesverbaleve të komisionit, që përkojnë me vendimet konkrete të fituese dhe jo fituesve nuk ka një relacion shpjegues si është deduktuar vlerësimi si fitues mbi 80 pikë. Ky vlerësim nuk është bazuar në rregulloren e grantit, pasi nuk ka një parashikim në të. Në rregulloren e grantit Pjesa X. Procedura e monitorimit të projekteve fituese është cilësuar se: “Fituesit do të shpallen sipas renditjes së pikëve të mbledhura, në raport me fondin total në dispozicion.”- Gjithashtu në rregullore nuk ka një parashikim mbi një përqindje apo shumë kundrejt totalit të parashikuar për tu shpërndarë në këtë thirrje midis dy kategorive startup apo lehtësues, megjithëse konstatohet se më



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	<p>shumë se 50%, (konkretisht 56%) të shumës së fondit të miratuar për tu shpërndarë i përket pikërisht kategorisë së lehtësuesve (dhe vetëm 44% i përket kategorisë së startup-eve).</p> <p>Nga auditimi i procesit, që prej krijimit të pasaportës së aplikuesit deri në vendimin e Komisionit të Vlerësimit në lidhje me listën e fituesve dhe jofituese u konstatua se janë miratuar fonde në dispozicion për startup-e në shumën 83,021,375 lekë ose 32% kundrejt shumës totale të miratuar dhe janë miratuar fonde në dispozicion të lehtësuesve në shumën 177,917,073 lekë ose 68% kundrejt totalit të fondeve totale të miratuara, konkretisht 260,938,448 lekë. Numri i aplikimeve fituese për startup-e përbëjnë 5% të totalit të aplikimeve për startup dhe numri i aplikimeve fituese për lehtësuesit përbëjnë 22% kundrejt totalit të aplikimeve për lehtësues.</p> <p>- Nga fondi total i miratuar, referuar vendimit nr. 1 të Komisionit të Vlerësimit konstatohet se, nga 29 përfitues të kategorisë lehtësues, 10 prej tyre ose 34% janë ente publike, prej të cilave 7 janë bashki, dhe 3 akademi. Shuma e miratuar për bashkitë është në masën 77,547,326 ose 44% të vlerës totale të miratuar. Nga auditimi i dokumentacionit shoqëruar së çdo aplikimi konstatohet se, në shpenzimet e kërkuara dhe të miratuara nga komisioni, janë përfshirë kosto për të cilat nuk ka një preventiv, ofertë apo shpenzime të mëparshme si dokumente justifikuese mbi të cilat ato janë mbështetur. Për parashikimin e vlerës e këtyre shpenzimeve nuk ka përcaktim në rregulloren e grantit duke krijuar mundësinë e mospërputhjes së shumës së miratuar për financim dhe faturave reale që do të paraqesin fituesit në momentin e disbursimit të fondit.</p>
Kriteri	Rregullorja e grantit, miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 3, (nr.2840 prot), datë 16.05.2022 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup -eve që aplikojnë për masa mbështetëse”.
Ndikimi/Efekti	Adresim jo i plotë i rregullores së grantit
Shkaku	Mungesë të një emërtimi specifik “Të thirrjes së parë” apo “E përgjithshme” në rregulloren e grantit. Mungesë përcaktimi mbi pikët kualifikuese të çdo aplikimi.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Ministri i Shtetit për mbrojtjen e Sipërmarrjes, të vlerësojë dhe marrë masat për përmirësimin e dokumentit të “Rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve që aplikojnë për masa mbështetëse”, miratuar me urdhrin nr.3, datë 16.5.2022 të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, pasi në rregulloren e grantit: a. Mungojnë filtrat e kontrollit paraprak të vlerësimit të dosjeve të çdo aplikanti për mbështetje me grante buxhetore, para shqyrtimit nga Komisioni i Vlerësimit; b. Nuk jepet asnjë detaj mbi mënyrën e kryerjes së procesit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	<p>vlerësimit dhe sekretimit të vlerësimeve të kryera nga ana e çdo anëtari,</p> <p>c. Mungon përcaktimi nga ana e çdo anëtari të Komisionit të Vlerësimit, i nivelit të grantit për çdo përfitues startup ose lehtësues të kualifikuar si fitues;</p> <p>d. Nuk ka një përshkrim mbi mënyrën si do të klasifikohet aplikimi nga fitues në jofitues apo anasjelltas, kundrejt pikëve të vlerësuara nga komisioni i vlerësimit. Në rregulloren e grantit mungon kriteri i pikëve, nën të cilin aplikimi nuk kualifikohet, pasi është cilësuar se: <i>“Fituesit do të shpallen sipas renditjes së pikëve të mbledhura, në raport me fondin total në dispozicion.”</i></p> <p>e. Mungon emërtimin specifik apo i përgjithshëm në lidhje me thirrjen për grant.</p> <p>f. Mungon parashikimi mbi dokumentin justifikues që duhet të paraqesë çdo aplikant në mbështetje të formatit të buxhetit për çdo projekt konkurrues.</p>
--	---

Konstatim nr. 5: Sipas dokumentacionit plotësues të vlerësimit me pikë për aplikimet, konstatohet se vlerësimi nga anëtarët është bërë në mënyrë të hapur dhe në vijim të të njëjtit dokument të përbashkët. Pikët finale janë përcaktuar në bazë të një mesatareje matematikore, bazuar në pikët e vendosura prej secilit anëtar. Në rregulloren e grantit nuk jepet një detajim mbi këtë pjesë të procesit, nuk ka një përshkrim mbi mënyrën si do të klasifikohet aplikimi nga fitues në jofitues apo anasjelltas kundrejt pikëve të vlerësuara nga komisioni i vlerësimit. Si rezultat bashkëlidhur apo në përbërje të procesverbaleve të komisionit, që përkojnë me vendimet konkrete të fituese dhe jo fituese nuk ka një relacion shpjegues si është deduktuar vlerësimi si fitues mbi 80 pikë. Ky vlerësim nuk është bazuar në rregulloren e grantit, pasi nuk ka një parashikim në të. Në rregulloren e grantit Pjesa X. Procedura e monitorimit të projekteve fituese është cilësuar se: *“Fituesit do të shpallen sipas renditjes së pikëve të mbledhura, në raport me fondin total në dispozicion.”*

Gjithashtu në rregullore nuk ka një parashikim mbi një përqindje apo shumë kundrejt totalit të parashikuar për tu shpërndarë në këtë thirrje midis dy kategorive startup apo lehtësues, megjithëse konstatohet se më shumë se 50%, (konkretisht 56%) të shumës së fondit të miratuar për tu shpërndarë i përket pikërisht kategorisë së lehtësuesve (dhe vetëm 44% i përket kategorisë së startup-eve).

Nga auditimi i procesit, që prej krijimit të pasaportës së aplikuesit deri në vendimin e Komisionit të Vlerësimit në lidhje me listën e fituesve dhe jofituese u konstatua se janë miratuar fonde në dispozicion për startup-e në shumën 83,021,375 lekë ose 32% kundrejt shumës totale të miratuar dhe janë miratuar fonde në dispozicion të lehtësuesve në shumën 177,917,073 lekë ose 68% kundrejt totalit të fondeve totale të miratuara, konkretisht 260,938,448 lekë. Numri i aplikimeve fituese për startup-e përbëjnë 5% të totalit të aplikimeve për startup dhe numri i aplikimeve fituese për lehtësuesit përbëjnë 22% kundrejt totalit të aplikimeve për lehtësues, sipas tabelës nr. 1 dhe 2 të mëposhtme.

Pas shqyrtimit të ankesave është miratuar dhënia e fondit për 6 startup-e të tjerë, miratuar me VKM nr. 618, datë 22.9.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr. 480, datë 13.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dhënies së granteve për startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve”, sipas listës aneksit bashkëlidhur. *Mënyra e përzgjedhjes dhe kualifikimit si fitues, i 6 startupeve*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË
SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

që kanë paraqitur ankim, nuk është audituar pasi shtrihet jashtë periudhës së auditimit, megjithatë konstatohet se me shtimin e kësaj shume vlera totale e miratuar në përfundim të thirrjes së parë do të jetë 283,899,734 lekë ose 95% të fondit rezervë të alokuar, duke mos u realizuar ky fond në shumën 16,100,266 ose 5% të tij.

Tabela nr. 1: Ndarja e aplikimeve midis fituese dhe jofituese në thirrjen e parë:

Përshkrimi	Jo fitues	Fitues	Aplikime total	Përqindje e fituesve kundrejt totalit të aplikimeve
Startup	475	23	498	5%
Lehtësues	101	29	130	22%
Total	576	52	628	8%

Burimi: MiSHMS, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr. 2: Ndarja e aplikimeve totale kundrejt fituesve sipas kategorisë në thirrjen e parë:

Përshkrimi	Numër	Shuma e miratuar e financimit	Përqindje e numrit të fituesve kundrejt totalit të aplikimeve	Përqindje e shumës së miratuar të financimit kundrejt totalit
Numri i startup-eve aplikantë	498			
Nr. i startup-eve fitues	23	83,021,375	44%	32%
Nr. i lehtësuesve aplikantë	130			
Nr. i lehtësuesve fitues	29	177,917,073	56%	68%
Shuma totale e miratuar për financim		260,938,448		100%
Numri total i fituesve	52		100%	
Numri total i jo fituesve	576			

Burimi: MiSHMS, përpunuar nga grupi i auditimit

- Për mbështetjen me grant, startup-et ndahen në tre kategori pasi plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- startup-et në fazën fillestare, që kanë përfunduar ose janë duke ndjekur një program inkubimi/përsheptimi;
- startup-et në fazën e rritjes, që janë të regjistruar në regjistrin tregtar nga 0–1 vit;
- startup-et në fazën e zgjerimit, që janë të regjistruar në regjistrin tregtar nga 1–5 vjet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Ndarja në tre kategori shoqërohet me mbështetje të ndryshme në grant, sipas fazave në të cilën vet deklarohet aplikanti.

- Në fazën fillestare përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në shumën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
- Startup-et në fazën e rritjes përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në shumën 3,000,000 (tre milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
- Startup-et në fazën e zgjerimit përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 5,000,000 (pesë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.

Gjatë auditimit të dokumentacionit shoqërues të aplikimeve për startup-e, u konstatua se:

- ✓ nga 23 fitues vetëm 3 ose 13% i përkasin fituesve të fazës fillestare,
- ✓ 5 ose 22% fazës së rritjes dhe
- ✓ 15 ose 65% fazës së zgjerimit.

Në varësi të fazës në të cilën është ndodhur startup-i konstatohet se shuma e miratuar për financim në varësi të projektit me të cilin startup-i ka aplikuar në thirrje është shpërndarë midis fazave përkatësisht:

- 6,227,000 lekë ose 8% të shumës për startup-e në fazë fillestare,
- 14,396,857 ose 17% të shumës për startup-e në fazë të rritjes dhe
- 62,397,518 ose 75% të shumës për startup-e në fazë të zgjerimit, sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela nr. 3: Ndarja e startup-eve fitues sipas nënkategorisë në thirrjen e pare, deri më datë 30.06.2022:

Fazat e startup-it	Fitues	Shuma e miratuar	Përqindja e fituese sipas fazës kundrejt totalit	Përqindja e shumës së miratuar sipas fazës kundrejt totalit
Faza fillestare	3	6,227,000	13%	8%
Faza e rritjes	5	14,396,857	22%	17%
Faza e zgjerimit	15	62,397,518	65%	75%
Shuma totale	23	83,021,375	100%	100%

Burimi: MiSHMS, përpunuar nga grupi i auditimit

Megjithëse ndarja në kategoritë e mësipërme bazohet në vet deklarin e aplikantit, konstatohet se kjo ndarje nuk është lidhur me fazën në të cilën ndodhet thirrja për mbështetje financiare. Kështu konstatohet se në aplikimet për startup përgjatë periudhës së vlefshme për aplikim, nga data 16 Maj 2022- 10 Qershor 2022 janë konstatuar regjistrime të reja në regjistrin tregtar në QKB të cilat kanë sjellë si rezultat vlerësimin e mundësisë së financimit të aplikuesit me një shumë më të madhe se faza në të cilën duhej të vlerësohej nëse nuk do të bënte këtë regjistrim, duke bërë pjesë tashmë në një kategori më të lartë. *Gjatë auditimit u konstatua se nga 5 startup-e*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË
SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

fitues në fazën e rritjes, 3 prej tyre (S0417, S0511 dhe S0778) konstatohen se janë regjistruar në regjistrin tregtar gjatë periudhës në të cilën thirrja e parë ka qenë e hapur.

Konstatim nr. 6: Nga fondi totali i miratuar, referuar vendimit të Komisionit të Vlerësimit konstatohet se, nga 29 përfitues të kategorisë lehtësues, 10 prej tyre ose 34% janë ente publike, prej të cilave 7 janë bashki, dhe 3 akademi. Shuma e miratuar për to është në masën 77,547,326 ose 44% të vlerës totale të miratuar, sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela nr. 4: Ndarja e lehtësuesve të startup-eve sipas llojit në thirrjen e parë:

Lloji i lehtësuesit	Shuma e miratuar	Numri i përfituesve	Përqindja e shumës së miratuar kundrejt totalit	Përqindja e numrit të përfituesve kundrejt totalit
Ent publik	77,547,326	10	44%	34%
Ojfi	52,680,947	10	30%	34%
Person fizik	16,977,600	3	10%	10%
Person juridik	30,711,200	6	17%	21%
Totali fondit të miratuar	177,917,073	29	100%	100%

Burimi: MiSHMS, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit shoqëruar së çdo aplikimi konstatohet se, në shpenzimet e kërkuara dhe pastaj të miratuara nga komisioni janë përfshirë kosto për të cilat nuk ka një preventiv, ofertë apo shpenzime të mëparshme si dokument justifikues. Për parashikimin e vlerës e këtyre shpenzimeve nuk ka përcaktim në rregullore duke krijuar mundësinë e mospërputhjes së shumës së miratuar për financim dhe faturave reale që do të paraqesin fituesit.

Kështu nga auditimi i dokumentacionit shoqëruar të aplikimit L.0, e përzgjedhur për tu përshkruar si enti publik me shumën më të lartë të miratuar nga Komisioni vlerësimit, ka të përfshirë në pasqyrën e saj të buxhetit të projektit rikonstruksion të “Qendër inovacioni dhe kreativiteti multifunksionale”, me shpenzim nr. 1 “Shpenzimi nr.1: Rehabilitimi i qendrës aktuale (rregullimi dhe rikonstruksioni i brendshëm i sallës për ta kthyer në ambient funksional, pajisjet e nevojshme teknologjike (projektor 3D, VR, PC, etj.)” në shumën 18,545,000 lekë dhe kosto të menaxhimit të projektit të burimeve njerëzore në shumën totale 2,222,112 lekë. Sipas shpjegimit të shpenzimit 1 në formularin e buxhetit “Kosto e restaurimit të qendrës, me punimet e nevojshme si restaurim mure, dysheme, dyer, dritare, infrastrukture energjetike dhe ujë, kosto të shtimit të infrastrukturës inovative për startup-et si pajisje teknologjike, VR, PC, Projektor, mobilim qendre me postacione pune, të gjitha do të prokurohen sipas procedurës ligjore të prokurimit publik me vlerë totale pa TVSH të procedurës = 18,545,000 leke”. Në formular nuk ka një detajim si është deduktuar tek kjo vlerë e shpenzimit.

- Nga formulari i aplikimit vihet re se zbatimi i projektit të mësipërm mendohet të jetë 4 muaj dhe do të ketë në përbërje 3 aktivitete ku secili ka të detajuar shumën e shpenzimit të planifikuar. Në shpenzimin nr. 5 “Burime njerëzore të brendshme” aplikanti L.0 ka parashikuar kostot e menaxhimit të projektit, si menaxher projekti, koordinatori projekti, asistent i qendrës, përgjegjës eventit, përgjegjës ligjor dhe PR& C me kohëzgjatje totale 4 muaj dhe kosto totale 2,222,112 lekë që planifikohen të mbulohen nga vetë bashkia. Megjithatë tek formulari i aplikimit nuk ka një



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

përshkrim të detyrën së secilit, ku dallon një detyrë nga tjetra, si dhe zhvillimi kohor i aktiviteteve të tyre nuk rezulton të jetë i njëjtë me kohëzgjatjen e projektit, por sipas aktivitetit nr. 2 vetëm dy muaj. Kosto e këtyre shpenzimeve nuk detajohet mbi c ‘bazë është vendosur, kjo përbën rëndësi për faktin se megjithëse vetëfinancohet, mund të rrisë fiktivisht koston totale dhe ndikon në masën e financimit të projektit nga fondi i startup-eve, i cili nuk duhet të kalojë 90% të kostove të lejuara.

- Përveç përfitimit të këtij granti në formularin e aplikimit konstatohet se aplikanti L.0 ka përfituar fonde të tjera në EU4 Innovation për qendrën multifunksionale për inovacion. Sipas përshkrimit në formular vihet re se 10% e stafit është i përfshirë në zhvillimin e programit të teknologjisë dhe inovacionit, si një prej programeve më të rëndësishme të këtij enti publik, megjithëse projekti aktual për të cilin aplikojnë me emërtim “Qendra inovatore dhe multifunksionale” në dokumentacionin bashkëlidhur nuk vihet re ndonjë informacion shtesë nëse kanë ndonjë lidhje këto projekte me njëra tjetrën.

Si përfundim,

Titulli i gjetjes nr. 9	Mungesa e vlerësimit individual dhe në mënyrë të pavarur i çdo aplikimi nga ana e Komisionit të Vlerësimit
Situata	<p>Nga auditimi i procesit të vlerësimit të aplikimeve gjatë thirrjes së parë konstatohet se, Komisioni i Vlerësimit të Mbështetjes me Grant të Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve është mbledhur në datat 15.06.2022; 16.06.2022; 17.06.2022; 18.06.2022 dhe 24.06.2022 me pjesëmarrjen e plotë të anëtarëve dhe ka përpiluar një procesverbal të vetëm me nr. 3805 prot., datë 29.06.2022, duke mos dokumentuar procesin e plotë të diskutimeve dhe minutave të takimit që i përket secilës prej këtyre takimeve/ mbledhjeve.</p> <p>Në Vendimin nr. 2, (nr.3806/2 prot), datë 29.06.2022 “Për jo fituesit e granteve financiare për mbështetjen e startup-eve” i hartuar në bazë të procesverbalin nr. 3805, datë 29.06.2020, Komisioni i Vlerësimit të Mbështetjes me Grant të Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve ka listuar aplikantët jo fitues të thirrjes së parë, e përbërë nga 475 startup-e dhe 101 lehtësues. E gjithë lista e jofituesve është cilësuar si e skualifikuar. Në vendim mungon një relacion shpjegues në lidhje me skualifikimet, Komisioni është mjaftuar vetëm me një renditje në formë tabelare të startup-eve dhe lehtësuesve të skualifikuar, krahas numrit përkatës identifikues dhe pikëve të caktuara për çdo aplikanti.</p>
Kriteri	Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Neni 16 “Procesverbali i mbledhjes”, Pika 1
Ndikimi/Efekti	Mungon vlerësimi individual dhe i pavarur i çdo anëtari të Komisionit të Vlerësimit
Shkaku	Mungesa e zbatimit të dispozitave ligjore
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	Të merren masat që të përmirësohet mënyra e vlerësimit në <i>mënyrë individuale e të pavarur</i> , e çdo aplikimi nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Mbështetjes me Grant të Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve, si dhe të dokumentohet me procesverbal të veçantë dhe



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHËTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	protokollohet çdo mbledhje e Komisionit sipas standardeve të parashikuara për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.
--	--

Konstatim nr. 7: Me Urdhrin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Nr. 4, (nr. 2841prot), datë 16.05.2022 “Për emërimin e menaxherit të skemës së granteve dhe masave mbështetëse”, është caktuar si menaxhere e grantit Znj. M.M, me pozicionin Këshilltar i Ministrit dhe me Urdhrin nr. 5 prot 2842, datë 16.05.2022 “Për ngritjen e strukturës përgjegjëse për shërbimin One-Stop-Shop” janë caktuar Znj. P.S, Sekretariati Teknik i KEK dhe Znj. K.Gj, Sekretariati Teknik i KEK. Emërimi i një funksionari politik në krye të funksionit administrativ të menaxhimit të grantit, detyrat e të cilit janë të përcaktuara në rregulloren e grantit si zbatimi dhe menaxhimi i grantit, bie në kundërshtim me Ligjin 90/ 2012 “Për funksionimin e administratës shtetërore”, Neni 17 “Kabinetet”, Pika 1. “

Kabineti i ministrit mund të ketë një drejtor, *këshilltarët* dhe sekretarët. Ata emërohen dhe shkarkohen nga ministri dhe *kanë statusin e funksionarëve politikë*, sipas ligjit”,

si dhe Kreu III, “Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore”, Seksioni I “Ministritë”, Neni 11.

Struktura e kabinetit mbështet drejtpërdrejt ministrin në ndjekjen e politikave përkatëse, realizimin e objektivave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të ministrisë. *Funksionarët e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror.*

Duke u nisur nga fakti që në strukturën e MiSHMS ka vetëm *funksionarë politikë*, menaxhimi i grantit nga njësia aktuale e menaxhimit të grantit (në krye të të cilës qëndron menaxheri i grantit), sjell një problematikë në vetvete, duke qenë kjo njësi, përgjegjëse për funksione administrative si certifikimi i shpenzimeve reale të kryera nga aplikantët fitues gjatë fazave të planifikuara të lëvrimit të kësteve.

Sipas bazës ligjore disbursimi i grantit për projektet e shpallura fituese bëhet deri në 3 këste, pas përfundimit të periudhës së mbylljes së çdo faze të projektit, kundrejt dorëzimit të faturës/ave të shpenzimeve të kryera dhe dokumentacionit të kërkuar, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në “Rregulloren e funksionimit grantit”. *Disbursimi i grantit të miratuar nga VKM nr. 375, datë 1.6.2022, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për zbatimin e ligjit nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” nuk është bërë pjesë e këtij auditimi nga ana e audituesve të autorizuar të KLSH-së, pasi shtrihet jashtë periudhës së këtij auditimi.*

Titulli i gjetjes nr. 10	<i>Parregullsi të ngarkimit të funksionarëve politikë me kryerjen e detyrave të karakterit administrativ</i>
Situata	Me Urdhrin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Nr. 4, (nr. 2841 prot), datë 16.05.2022 “Për emërimin e menaxherit të skemës së granteve dhe masave mbështetëse”, është caktuar si menaxhere e grantit Znj. M.M, me pozicionin Këshilltar i Ministrit dhe me Urdhrin nr. 5 prot 2842, datë 16.05.2022 “Për ngritjen e strukturës përgjegjëse për shërbimin One-Stop-Shop” janë caktuar Znj. P.S, Sekretariati Teknik i KEK dhe Znj. K.Gj, Sekretariati Teknik i KEK. Emërimi i një funksionari politik në krye të funksionit administrativ të menaxhimit të grantit, detyrat e të cilit janë të përcaktuara në rregulloren e grantit si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	zbatimi dhe menaxhimi i grantit, bie në kundërshtim me Ligjin 90/ 2012 “Për funksionimin e administratës shtetërore”, Neni 17 “Kabinetet”, Pika 1, si dhe Kreu III, “Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore”, Seksioni 1 “Ministritë”, Neni 11. Duke u nisur nga fakti që në strukturën e MiSHMS ka vetëm <i>funksionarë politikë</i> , menaxhimi i grantit nga njësia aktuale e menaxhimit të grantit (në krye të të cilës qëndron menaxheri i grantit), sjell një problematikë në vetvete, duke qenë kjo njësi, përgjegjëse për funksione administrative si certifikimi i shpenzimeve reale të kryera nga aplikantët fitues gjatë fazave të planifikuara të lëvrimit të kësteve.
Kriteri	Ligji 90/ 2012 “Për funksionimin e administratës shtetërore”, Neni 17 “Kabinetet” ,Pika 1, si dhe Kreu III, “Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore”, Seksioni 1 “Ministritë”, Neni 11.
Ndikimi/Efekt	Kryerja e funksioneve administrative nga funksionarë politikë
Shkaku	Mungesa e personelit me funksion administrativ brenda MiSHMS
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	MiSHMS të marrë masa që në përmbushjen e detyrës së menaxhimit të grantit të emërojë punonjës me funksione administrative konform dispozitave ligjore në fuqi.

Konstatim nr. 8/a). Mbi pajisjen me pasaportë dhe regjistrin e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve:

Pjesëmarrja në vlerësimin e projekteve për mbështetje financiare kërkon paraprakisht pajisjen me pasaportën përkatëse sipas kategorisë.

○ Gjatë auditimit të regjistrin të startup-eve dhe krahasimit të të dhënave me pasaportën e startup-it u konstatua se janë dhënë 967 pasaporta startup-i, 48 e të cilave rezultojnë të kenë ose të njëjtin emër tregtar, ose të njëjtin NIPT regjistrimi në regjistrin tregtar ndërkohë që 1(një) prej tyre është i pajisur me pasaportë lehtësuesi.

○ Kështu u konstatuan se janë pajisur me nga 2 pasaporta të ndryshme startup-i, 22 startup-e duke patur të njëjtin emër tregtar, si dhe 15 startup-e me të njëjtin numër në regjistrin tregtar.

○ Nga auditimi i regjistrin të lehtësuesve të startup-eve konstatohet se nga 238 lehtësues, janë pajisur me pasaporta të ndryshme lehtësuesi 5 aplikantë me të njëjtin numër identifikimi në regjistrin tregtar.

Pajisja e startup-eve dhe lehtësuesve me të njëjtin numër identifikimi në regjistrin tregtar me pasaporta të ndryshme merr rëndësi për faktin e pamundësisë së marrjes pjesë së tyre tek e njëjta thirrje sipas përcaktimeve në rregulloren e grantit, si dhe në shtimin e numrit të përgjithshëm të startup-eve dhe lehtësuesve duke cenuar saktësinë e regjistrin. Konstatimi i referohet tabelës nr. 5 dhe 6 të mëposhtme.

Në lidhje me sa më sipër, me anë të shkresës nr. 4979/10, datë 04.01.202, të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, protokolluar në KLSH me nr. 792/6 prot., datë 09.01.2023, është theksuar se si më poshtë:

Qëndrimi i subjektit, MiSHMS:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Aplikimi për pasaportën e startup-it ose lehtësuesit të startup-it kryhet nëpërmjet portalit e-albania. Në formularin e aplikimit që plotëson aplikuesi në portal, janë të përfshira të gjitha fushat e informacionit që kërkohen në VKM nr. 312 dt. 11.05.2022.

Në sistemin menaxhues të aplikimeve, me aksesin e dhënë nga AKSHI, MiSHMS akseson të gjithë informacionin sipas fushave të përcaktuara në VKM dhe regjistrin elektronik.

Dokumenti “Databaza e Pasaportave” në excel, i vënë në dispozicion grupit auditues, është një dokument i mbajtur nga stafi i brendshëm i MiSHMS, për lehtësi të menaxhimit të procesit, por nuk përfaqëson dhe nuk zëvendëson regjistrin elektronik të parashikuar në ligjin 25/2022 dhe VKM 312, 11.05.2022, pasi ky regjistër gjendet vetëm në sistemin elektronik të portalit e-albania, menaxhuar nga AKSHI dhe aksesuar nga MiSHMS.

AKSHI në bashkëpunim me MiSHMS është duke ngritur një sistem të dedikuar elektronik për aplikimin, menaxhimin dhe mbajtjen e regjistrit të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve, i cili parashikohet të jetë gati në fillim të këtij viti.

MiSHMS në bashkëpunim me AKSHI ka përgatitur manualet e përdorimit për të dy tipet e pasaportave dhe këto manuale janë publikuar në faqen e MiSHMS, shoqëruar me videot ilustruese, sipas linjeve më poshtë:

https://sipermarrja.gov.al/ep-content/uploads/2022/05/Manuali_Pasaporta-e-lehtesuesit.pdf

https://sipermarrja.gov.al/ep-content/uploads/2022/05/Manuali_Pasaporta-e-startup.pdf

Qëndrimi i grupit të auditimit: Duke qenë se përgjegjja e MiSHMS nuk sjell argumente të tjera ligjore përveç atyre të pashqyrtuara dhe diskutuara më parë, kërkohet zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti. Megjithatë AKSHI-t i është bërë kërkesë zyrtare në shkresën cituar në observacion me nr.4159 prot. Date 15/07/2022 për ngritjen e një sistemi të dedikuar elektronik për aplikimin, menaxhimin dhe mbajtjen e regjistrit të startup- eve dhe lehtësuesve të startup-eve, nuk është audituar nga grupi i auditimit pasi shtrihet jashtë periudhës së këtij auditimi.

8/b). MiSHMS nuk përdor aktualisht një manual të brendshëm për organizimin dhe funksionimin e këtij regjistri, në kundërshtim me Ligjin 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, Neni 5, “Administrimi i bazës së të dhënave shtetërore”:

“Administrimi i bazës së të dhënave shtetërore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi. Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit 10 të këtij ligji”,

si dhe me VKM nr. 312, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për përmbajtjen e regjistrit të startup-eve dhe lehtësuesve, mënyrën e funksionimit dhe ndërlidhjen e tij me portalin qeveritar e-albania, si dhe për dokumentet elektronike pasaporta e startup-eve dhe pasaporta e lehtësuesve”, Kreu V, “Dispozita të fundit”,

“Ministri përgjegjës për sipërmarrjen është përgjegjës për menaxhimin e regjistrit dhe krijimin e manualit të përdorimit të regjistrit”.

8/c). Nga auditimi i regjistrit të startup-eve dhe lehtësuesve konstatohet se ky dokument, nuk i përmban të gjitha të dhënat parësore dhe nuk i përmban kryesisht të gjitha të dhënat dytësore, të parashikuara në VKM 312, datë 11.05.2022 “Përcaktimin e rregullave të hollësishme për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

përmbajtjen e regjistrit të startup-eve dhe lehtësuesve, mënyrën e funksionimit dhe ndërlidhjen e tij me portalin qeveritar “e-albania” si dhe për dokumentet elektronike – pasaporta e startup-eve dhe pasaporta e lehtësuesve, Pika 1 dhe 2, a) iv, v, vii dhe b), të cilat duhet të përmbajnë të dhënat e numrit të pjesëtarëve të startup-it, fushën ku operon, përshkrimi i startup-it, datën e regjistrimit në regjistrin tregtar, selinë, kontakte etj.

Titulli i gjetjes nr. 11	<i>Mbi pajisjen me pasaportë dhe regjistrin e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve:</i>
Situata	<p>Gjatë auditimit të regjistrit të startup-eve dhe krahasimit të të dhënave me pasaportën e startup-it u konstatua se janë dhënë 967 pasaporta startup-i, 48 e të cilave rezultojnë të kenë ose të njëjtin emër tregtar, ose të njëjtin numër regjistrimi (NUIS) në regjistrin tregtar ndërkohë që 1(një) prej tyre është i pajisur me pasaportë lehtësuesi. Kështu u konstatuan se janë pajisur me nga 2 pasaporta të ndryshme startup-i, 22 startup-e duke patur të njëjtin emër tregtar, si dhe 15 startup-e me të njëjtin numër në regjistrin tregtar.</p> <p>Nga auditimi i regjistrit të lehtësuesve të startup-eve konstatohet se nga 238 lehtësues, janë pajisur me pasaporta të ndryshme lehtësuesi 5 aplikantë me të njëjtin numër identifikimi në regjistrin tregtar.</p> <p>Pajisja e startup-eve dhe lehtësuesve me të njëjtin numër identifikimi në regjistrin tregtar me pasaporta të ndryshme merr rëndësi për faktin e pamundësisë së marrjes pjesë së tyre tek e njëjta thirrje sipas përcaktimeve në rregulloren e grantit, si dhe në shtimin e numrit të përgjithshëm të startup-eve dhe lehtësuesve duke cenuar saktësinë e regjistrit.</p> <p>MiSHMS nuk përdor aktualisht një manual të brendshëm për organizimin dhe funksionimin e këtij regjistri.</p> <p>Nga auditimi i regjistrit të startup-eve dhe lehtësuesve konstatohet se ky dokument është vetëm elektronik dhe nuk i përmban të gjitha të dhënat parësore dhe nuk i përmban kryesisht të gjitha të dhënat dytësore, të parashikuara në VKM 312, datë 11.05.2022 “Përcaktimin e rregullave të hollësishme për përmbajtjen e regjistrit të startup-eve dhe lehtësuesve, mënyrën e funksionimit dhe ndërlidhjen e tij me portalin qeveritar “e-albania” si dhe për dokumentet elektronike – pasaporta e startup-eve dhe pasaporta e lehtësuesve, Pika 1 dhe 2, a) iv, v, vii dhe b), të cilat duhet të përmbajnë të dhënat e numrit të pjesëtarëve të startup-it, fushën ku operon, përshkrimi i startup-it, datën e regjistrimit në regjistrin tregtar, selinë, kontakte etj.</p>
Kriteri	<p>Ligji 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, Neni 5, “Administrimi i bazës së të dhënave shtetërore”, VKM nr. 312, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për përmbajtjen e regjistrit të startup-eve dhe lehtësuesve, mënyrën e funksionimit dhe ndërlidhjen e tij me portalin qeveritar e-albania, si dhe për dokumentet elektronike pasaporta e startup-eve dhe pasaporta e lehtësuesve”, Kreu V VKM 312, datë 11.05.2022 “Përcaktimin e rregullave të hollësishme për përmbajtjen e regjistrit të startup-eve dhe lehtësuesve, mënyrën e funksionimit dhe ndërlidhjen e tij me portalin qeveritar “e-albania” si</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

	dhe për dokumentet elektronike – pasaporta e startup-eve dhe pasaporta e lehtësuesve, Pika 1 dhe 2, a) iv, v, vii dhe b)
Ndikimi/Efekti	Regjistri i startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve është i pa lote dhe me dublikime të pasaportave të startup-eve dhe lehtësuesve.
Shkaku	Kryerja në mënyrë manuale e pajisjes me pasaporta.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	MiSHMS të marrë masa kundrejt përmirësimit të regjistrit të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve si më poshtë: a) Në eliminimin e dublikimeve të pasaportave të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve; b) në plotësimin me të dhënat parësore dhe dytësore të çdo mbajtësi të pasaportës; c) në hartimin dhe vënien në përdorim të një manuali mbi organizimin dhe funksionimin e këtij regjistri; d) në hartimin e një dokumenti hardcopy të regjistrit të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve në funksion të ruajtjes të formës së pandryshuar konform vitit të cilit i përkon.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET:

Në përfundim për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN DHE AKTET NËNLIGJORE NË FUQI:

1.Gjetje nga auditimi:

Gjatë periudhës objekt auditimi rezultoi se, fusha e përgjegjësisë dhe e kompetencave të këtij institucioni publik, (miratuar me VKM nr. 511, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, shfuqizuar nga VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”), ka elementë të mbivendosjes së tyre me ato të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, institucion i krijuar nga Ligji Nr.107/2021, datë 4.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”. Duke marrë parasysh ndryshimet që kanë ndodhur në aktet ligjore dhe nënligjore, konstatohet që efektivisht, fusha e veprimtarisë shtetërore të MiSHMS ka ndryshuar, duke kaluar nga një institucion që investigon dhe trajton ankesat administrative të sipërmarrjeve private, (përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike), në një institucion promovues të sipërmarrjes dhe zhvillimit e koordinimit të politikave shtetërore në fushën e mbështetjes së startup-eve dhe mbështetjen e ekosistemit të tyre. Ligji nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” përcakton se fusha e veprimtarisë shtetërore, që përfshihet brenda një ministrie, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Rezultoi se, ky ndryshim i fushëveprimit, përgjegjësisë dhe kompetencave të MiSHMS, nuk është reflektuar me përmirësimet e nevojshme të VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



1.1.Rekomandimi:

Sa më sipërm, për të evituar përplasjet e mundshme të kompetencave dhe të fushës së përgjegjësive zyrtare, me qëllim qartësimin e objektit të veprimtarisë, institucioni i Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në bashkëpunimin me Kryeministrinë, të marrë masat për hartimin dhe propozimin e përmirësimeve të nevojshme të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke ngritur një grup pune për rishikimin dhe ridimensionimin e fushës së veprimtarisë, për të paraqitur sa më drejtë rolin, misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit, përmes ndryshimeve në VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”.

Afati: Brenda 6 muajsh

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e sipërmarrjes është njëkohësisht dhe Kryetar i Këshillit të startup-eve dhe Kryetar i Komisionit të vlerësimit të dhënies se granteve për mbështetjen e startup-eve. *Kështu*, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 8, të Ligjit nr. 25, datë 10.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, Ministri i Shtetit të Mbrojtjes së Sipërmarrjes është Kryetar i Këshillit të Startup-eve, si dhe sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 14 të po këtij ligji, Ministri i Shtetit të Mbrojtjes së Sipërmarrjes është dhe Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të dhënies se granteve për mbështetjen e startup-eve. Këshillit i startup-eve si organ kolegjal ka kompetenca si dhënien e kontributit për politikën ekzistuese në nxitjen e zhvillimit të startup-eve dhe ekosistemit, ndërsa Komisioni i Vlerësimit të dhënies se granteve për mbështetjen e startup-eve është organ vlerësues për kërkesat e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve përgjatë procesit konkurrues. Detyra e kryesimit të Komisionit të vlerësimit sipas kompetencave të përcaktuara në pikën 13, Kreu IV të VKM nr.313, datë 11.5.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të vlerësimit, si dhe të kriterëve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij” përbën një funksion administrativ. Përbushja e detyrës së vlerësimit të fituesve apo jo fituesve pas një procesi konkurrues nga Ministri cenon linjën e raportimit të procesit të vlerësimit të projekteve inovative. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me Ligjin 90/2012, datë 27.9.2012 “Për funksionimin e administratës shtetërore”, Seksioni 1 “Ministritë”, Neni 11 “Struktura e ministrisë”, pika 1 dhe Ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 8 Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1 dhe pika 8/a dhe d.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 3, faqe 31-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi:

Të merren masat nga ana e Ministrisë të Shtetit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes, që, të bëhen propozimet për përmirësimet e nevojshme të kuadrit ligjor në fuqi, përkatësisht të,

- pikës 4, të Nenit 14 “Mbështetja e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse”, të Ligjit nr. 25, datë 25.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, si dhe
- pikës 3, të Kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 315, datë 11.05.2022, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të kriterëve të procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”,

duke synuar përbushjen e qëllimeve, politikave dhe të objektivave të këtij institucioni shtetëror me kërkesat e ligjit “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të kontrollit të brendshëm, që siguron ndarjen e duhur të përgjegjësive administrative që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe linjat e raportimit.



Afati: Në vijimësi

C. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi:

Institucioni i MiSHMS për periudhën 10.09.2017 deri më 30.6.2022 ka funksionuar pa një rregullore të brendshme të miratuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, nenit 29, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe nenit 8” Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika nr.1 dhe nr.8, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Strategjia për Ndërveprim mes Sipërmarrjes dhe Institucioneve Publike është dokument i përgatitur nga ana e MiSHMS në vitin 2018, por që nuk i është nënshtruar rishikimit çdo 3 vjet, në përputhje me kërkesat e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.Rekomandimi:

1.1. Nga ana e institucionit të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të merren masat për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të institucionit, në përputhje me detyrimet që rrjedhin sipas pikës nr. 4/b, të VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, duke përcaktuar rregullat lidhur me organizimin, funksionimin e brendshëm dhe veprimtarinë e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, detyrat funksionale të përgjithshme dhe të veçanta të Kabinetit, metodat e brendshme të punës dhe mbarëvajtjen dhe disiplinën në marrëdhëniet e punës dhe etikën profesionale të stafit, procedurat e komunikimit ndërmjet tyre dhe Koordinatorit përkatës në Zyrën e Bashkëqeverisjes, etj. Dokumenti i rregullores së brendshme duhet të pasqyrojë rolin e MiSHMS në kuadër të Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar”, funksione dhe veprimtari që kanë si bazë Ligjin nr.57/2014 “Për Këshillin Ekonomik Kombëtar” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.281, datë 16.5.2018.

Afati: Në vijimësi.

1.2. Të merren masat për rishikimin dhe miratimin e Strategjisë për Ndërveprim mes Sipërmarrjes dhe Institucioneve Publike, bazuar në kompetencat dhe ridimensionimin e rolit dhe funksioneve të MiSHMS, jo vetëm si mekanizmi që u mundëson bizneseve të kanalizojnë dhe të advokojnë shqetësimet dhe propozimet e tyre për Qeverinë, por edhe si dhe një instrument për të ndërmjetësuar dhe lehtësuar komunikimin mes sipërmarrjes dhe institucioneve publike dhe për nxitjen e startup-eve.

Afati: Në vijimësi.

2 . Gjetje nga auditimi:

Në institucionin e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, nuk janë marrë masat për hartimin dhe miratimin e një Rregulloreje për Trajtimin e Ankesave¹¹, veprime jo në pajtueshmëri me përcaktimet e pikës nr.4, germa “b”, të VKM nr. 511, date 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës

¹¹- Audituesit e KLSH nuk kanë rekomanduar hartimin e rregullores për trajtimin e ankesave, meqenëse, ky proces është rregulluar dhe disiplinuar nga ligji nr. 107/2021, datë 4.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

se përgjegjësisë se ministrit të shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes”, i shfuqizuar, dhe të Rregullores së Brendshme të funksionimit të MiSHMS.

Regjistri Analitik i Komunikimit të Brendshëm të Trajtimit të Ankesave është një dokument i regjistruar në excel, ku gjenerohen të dhëna për periudhën Janar 2020 - Korrik 2021, prej të cilave janë hartuar dhe publikuar raporte mujore vetëm për periudhën Tetor 2017 deri në muajin Nëntor 2020 .

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi:

Të merren masat për ndjekjen në vijimësi të backlogut të ankesave të sipërmarrjes private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe të huaj, në proces shqyrtimi, të cilat janë të mbartura prej vitesh dhe shtrihen brenda juridiksionit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, si dhe atyre ankesave që janë dërguar për kompetencë në vijimësi nga ana e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, kur MiSHMS është institucioni përgjegjës për monitorimin, ndjekjen dhe trajtimin e çështjeve të regjistruara në seksionet e platformës “*Me ty për Shqipërinë që duam*”. Për sa sipër, në kuadër të promovimit të transparencës dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të sipërmarrjes, të publikohen rregullisht raportet mujore mbi ecurinë e shqyrtimit të këtyre ankesave.

Afati: Në vijimësi.

3. Gjetje nga auditimi:

Në institucionin e MiSHMS për periudhën objekt auditimi nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurma auditimit për proceset kryesore, në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr.4, të VKM nr. 511, date 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë se ministrit të shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes”, nenit 4, pika 19, si dhe nenit 16, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Po kështu, nga ana e MiSHMS nuk është hartuar dhe depozituar tek nëpunësi i parë autorizues në MFE sipas afateve ligjore në fuqi për periudhe e audituar , Pyetëtori i Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti Vjetor përkatës mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të kësaj njësie publike të qeverisjes qendrore.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3. Rekomandimi:

3.1.Të merren masat nga ana e institucionit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, për përgatitjen dhe miratimin e gjurmës së auditimit të proceseve kryesore (të tilla si, skema e përfitimit / financimi i granteve për thirrjet e startupeve dhe lehtësuesve, promovimin e sipërmarrjes, ndjekjen e ankesave të subjekteve të biznesit me statusin në “Proces Verifikimi” që janë brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, koordinimin me hallkat e tjera të administratës dhe rolin në kuadër të sekretariatit të KEK, etj.).

Afati: Në vijimësi.

3.2.Nga ana e MiSHMS të merren masat për hartimin dhe depozitimin tek nëpunësi i parë autorizues, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit pasardhës, të Pyetëtorit të Vetëvlerësimit, Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm të kësaj njësie publike, për vitin e mëparshëm dhe të Planit të Veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

Afati: Në vijimësi.

4. Gjetje nga auditimi:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Objektivat e “Strategjisë për ndërveprim mes sipërmarrjes dhe institucioneve publike”, të institucionit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, nuk janë shoqëruar me indikatorë të matshëm, ç’ka do të lehtësonte matjen e performancës institucionale drejt realizimit të këtyre objektivave. Nga auditimi u konstatua se nga ana e Ministrisë nuk janë hartuar plane veprimi dhe raporte performance (6-mujore e vjetore) mbi ecurinë e zbatimit të kësaj strategjie sipas drejtimeve të saj.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi:

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes të marrë masat që, hartimi i strategjisë së re institucionale, ku të përfshihen objektiva SMART (*specifikë, të matshëm, të arritshëm, të përshtatshëm dhe me kohë të përcaktuar*), të shoqërohet me plan-veprimet përkatëse të detajuara, ku të përcaktohet edhe metodologjia e monitorimit periodik të saj.

Afati: Brenda 3 muajsh.

5. Gjetje nga auditimi:

Gjatë auditimit u konstatua se, në faqen zyrtare të MiSHMS të postuar më 20.05.2022, është publikuar se për startup-et do të shpërndahen 10 milionë euro, për mbështetjen e të rinjve në botën e sipërmarrjes. Mbështetja e mësipërme financiare përbën një angazhim të Qeverisë së Shqipërisë për tu shpërndarë në 4 thirrje për startup-e në shumë të barabartë (2.5 milionë euro secili), por pa u vënë në dispozicion të audituesve të autorizuar të KLSH-së të ndonjë dokumentacioni tjetër mbështetës mbi planifikimin financiar strategjik të tij.

5.1. Fondet e miratuara për thirrjen e parë për mbështetjen financiare të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve konstatohet se i përkasin fondit rezervë të buxhetit të shtetit për vitin 2022, në shumën 300 milionë lekë, alokuar sipas VKM nr. 375, datë 1.6.2022 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për zbatimin e ligjit nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”.

5.2. Gjatë auditimit konstatohet se, shuma e vënë në dispozicion për thirrjen e parë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit ka qenë 300 milionë lekë, në përfundim të thirrjes së parë deri në fund të periudhës së auditimit datë 30.06.2022 është miratuar për financim shuma 260,938,448 lekë, e cila është 39,061,552 lekë ose 13% më pak se shuma e parashikuar për tu shpërndarë gjatë kësaj thirrjeje. Referuar përcaktimeve të Rregullores së Grantit dhe Kodit të Procedurave Administrative, pas shqyrtimit të ankimit të 17 aplikantëve, 6 prej tyre kaluan me sukses procesin e rivlerësimit, (sipas VKM nr.618, dt.22.09.2022) dhe në përfundim, mosrealizimi i fondit rezervë është në masën 5%, pasi niveli total i grantit të miratuar është 283,899,734 lekë.

5.3. Gjatë fazave të përgatitjes së projekt ligjit për startup-et, miratimit të ligjit përkatës, por dhe deri në fund të periudhës së auditimit konstatohet se, nuk janë paraqitur nga ana e MiSHMS kërkesa buxhetore për fonde të lidhura me mbështetjen e inovacionit. Duke mos patur kërkesa buxhetore të përgatitura nga MiSHMS në bashkëpunim me Njësinë e Buxhetit dhe Administrimit në Kryeministri nga e cila ka varësi, fondet për thirrjet për grante për vitin 2023, nëse do të ndiqen disiplina standarde e planifikimit buxhetor, mbart riskun e mos përfshirjes në PBA e vitit 2023-2025 si dhe në buxhetin e vitit 2023.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 3, faqe 31-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5. Rekomandimi:



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

5.1. Të merren masat nga ana e Ministrit të Shtetit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes, që, në përputhje me përcaktimet e nenit 7, geramat “c” dhe “ç”, të ligjit nr. 25/2022, datë 10.3.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, të koordinohen veprimet me ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë për planifikimin buxhetor të fondeve të startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta sipas kërkesave standarde të planifikimit buxhetor, me qëllimin e shmangies së praktikës së deritanishme të përdorimit të fondit rezervë për financimin e shpenzimeve të parashikuara në programin qeveritar të miratuar nga Kuvendi.

Afati: Në vijimësi

5.2. Në kushtet që, MiSHMS si një ministri pa portofol dhe me numër të reduktuar kapacitetesh (pesë punonjës), nuk ka në strukturë një funksion të dedikuar për financën, për kryerjen e planifikimit buxhetor të bashkëpunohet ngushtësisht me Kryeministrinë, konform parashikimeve të pikës nr. 27, të VKM Nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm” dhe mbi këtë bazë ti propozojë Këshillit të Ministrave miratimin e fondeve buxhetore për grantet dhe format e tjera të mbështetjes së startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Afati: Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi

Megjithëse sipas përcaktimit në pikën 3, të nenit 14, të Ligjit 25/2022, thirrjet për grant do të hapen sipas prioritete të përgjithshme që duhet të plotësojnë projektet konkurruese, gjatë auditimit nuk u konstatua shpallja e thirrjes së parë të mbështetjes me grant sipas një prioriteti specifik. Veprimi i mësipërm sjell riskun e krijimit të një procesi të pa adresuar të mbështetjes me grant. *(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 3, faqe 31-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1 Rekomandimi:

Në kuadër të rishikimit të strategjisë, MiSHMS të marrë masa mbi hartimin dhe reflektimin e një plani në lidhje me prioritetin përkatës së çdo thirrjeje për grant në funksion të krijimit të një procesi të adresuar të mbështetjes me grant.

Afati: Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi:

Rregullorja e grantit nuk është e emërtuar si një rregullore specifike për thirrjen e parë megjithëse në afatet e thirrjes rezulton të përfshijë vetëm vitin 2022 apo nuk përmban një tabelë kohore me afate të standardizuara e gjithëpërfshirëse, të vlefshme për të gjitha thirrjet e mundshme për grant.

7.1. Megjithëse vlefshmëria, shpallja e fituesve dhe lidhja e kontratave të thirrjes së parë për grant janë shpallur në përmbushje të Rregullores “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve që aplikojnë për masa mbështetëse”, gjatë auditimit konstatohet se datat e tyre kanë qenë subjekt i vazhdueshëm i ndryshimit, pas njoftimeve përkatëse në faqen zyrtare të MiSHMS, konkretisht me Njoftimin e MiSHMS Nr. 3223, datë 03.06.2022 dhe Njoftimin Nr. 3697, datë 27.06.2022 “Njoftim mbi shtyrjen e shpalljes së fituesve.

7.2. Procesverbalet e Komisionit, që përkojnë me vendimet konkrete të fituesve dhe jo fituesve nuk janë shoqëruar me një relacion shpjegues si është deduktuar vlerësimi i fituesve mbi 80 pikë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Ky vlerësim nuk është bazuar në rregulloren e grantit, pasi nuk ka një parashikim të tillë në rregullore. Në rregulloren e grantit, pjesa X “Procedura e monitorimit të projekteve fituese”, është cilësuar se: *“Fituesit do të shpallen sipas renditjes së pikëve të mbledhura, në raport me fondin total në dispozicion.”*

7.3. Gjithashtu në rregulloren e grantit nuk ka një parashikim mbi një përqindje apo shumë kundrejt totalit të parashikuar për tu shpërndarë në këtë thirrje midis dy kategorive startup apo lehtësues, megjithëse konstatohet se më shumë se 50%, (konkretisht 56%) të shumës së fondit të miratuar për tu shpërndarë i përket pikërisht kategorisë së lehtësuesve (dhe vetëm 44% i përket kategorisë së startup-eve). Nga auditimi i procesit, që prej krijimit të pasaportës së aplikuesit deri në vendimin e Komisionit të Vlerësimit në lidhje me listën e fituesve dhe jofituese u konstatua se janë miratuar fonde në dispozicion për startup-e në shumën 83,021,375 lekë ose 32% kundrejt shumës totale të miratuar dhe janë miratuar fonde në dispozicion të lehtësuesve në shumën 177,917,073 lekë ose 68% kundrejt totalit të fondeve totale të miratuara, konkretisht 260,938,448 lekë. Numri i aplikimeve fituese për startup-e përbëjnë 5% të totalit të aplikimeve për startup dhe numri i aplikimeve fituese për lehtësuesit përbëjnë 22% kundrejt totalit të aplikimeve për lehtësues.

7.4. Nga fondi total i miratuar, referuar vendimit nr. 1 të Komisionit të Vlerësimit konstatohet se, nga 29 përfitues të kategorisë lehtësues, 10 prej tyre ose 34% janë ente publike, prej të cilave 7 janë bashki, dhe 3 akademi. Shuma e miratuar për bashkitë është në masën 77,547,326 ose 44% të vlerës totale të miratuar. Nga auditimi i dokumentacionit shoqëruar së çdo aplikimi konstatohet se, në shpenzimet e kërkuara dhe të miratuara nga komisioni janë përfshirë kosto për të cilat nuk ka një preventiv, ofertë apo shpenzime të mëparshme si dokumente justifikuese mbi të cilat ato janë mbështetur. Për parashikimin e vlerës e këtyre shpenzimeve nuk ka përcaktim në rregulloren e grantit duke krijuar mundësinë e mospërputhjes së shumës së miratuar për financim dhe faturave reale që do të paraqesin fituesit në momentin e disbursimit të fondit.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 3, faqe 31-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi:

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të vlerësojë dhe marrë masat për përmirësimin e dokumentit të “Rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishtme për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve që aplikojnë për masa mbështetëse”, miratuar me urdhrin nr.3, datë 16.5.2022 të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, pasi në rregulloren e grantit:

- g. Mungojnë filtrat e kontrollit paraprak të vlerësimit të dosjeve të çdo aplikanti për mbështetje me grante buxhetore, para shqyrtimit nga Komisioni i Vlerësimit;
- h. Nuk jepet asnjë detaj mbi mënyrën e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe sekretimit të vlerësimeve të kryera nga ana e çdo anëtari;
- i. Mungon përcaktimi nga ana e çdo anëtari të Komisionit të Vlerësimit, i nivelit të grantit për çdo përfitues startup ose lehtësues të kualifikuar si fitues;
- j. Nuk ka një përshkrim mbi mënyrën si do të klasifikohet aplikimi nga fitues në jofitues apo anasjelltas, kundrejt pikëve të vlerësuara nga komisioni i vlerësimit. Në rregulloren e grantit mungon kriteri i pikëve, nën të cilin aplikimi nuk kualifikohet, pasi është cilësuar se: *“Fituesit do të shpallen sipas renditjes së pikëve të mbledhura, në raport me fondin total në dispozicion.”*
- k. Mungon emërtimin specifik apo i përgjithshëm në lidhje me thirrjen për grant;



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

1. Mungon parashikimi mbi dokumentin justifikues që duhet të paraqesë çdo aplikant në mbështetje të formatit të buxhetit për çdo projekt konkurrues.

Afati: Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procesit të vlerësimit të aplikimeve gjatë thirrjes së parë konstatohet se, Komisioni i Vlerësimit të Mbështetjes me Grant të Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve është mbledhur në datat 15.06.2022; 16.06.2022; 17.06.2022; 18.06.2022 dhe 24.06.2022 me pjesëmarrjen e plotë të anëtarëve dhe ka përpiluar një procesverbal të vetëm me nr. 3805 prot., datë 29.06.2022, duke mos dokumentuar procesin e plotë të diskutimeve dhe minutave të takimit që i përket secilës prej këtyre takimeve/ mbledhjeve.

Në Vendimin nr. 2, (nr.3806/2 prot), datë 29.06.2022 “Për jo fituesit e granteve financiare për mbështetjen e startup-eve” i hartuar në bazë të procesverbalin nr. 3805, datë 29.06.2020, Komisioni i Vlerësimit të Mbështetjes me Grant të Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve ka listuar aplikantët jo fitues të thirrjes së parë, e përbërë nga 475 startup-e dhe 101 lehtësues. E gjithë lista e jo fituesve është cilësuar si e skualifikuar. Në vendim mungon një relacion shpjegues në lidhje me s kualifikimet, Komisioni është mjaftuar vetëm me një renditje në formë tabelare të startup-eve dhe lehtësuesve të skualifikuar, krahas numrit përkatës identifikues dhe pikëve të caktuara për çdo aplikant. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Neni 16 “Procesverbali i mbledhjes”, pika 1.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 3, faqe 31-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi:

Nga MiSHMS të merren masat që të përmirësohet mënyra e vlerësimit në mënyrë individuale e të pavarur, e çdo aplikimi nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Mbështetjes me Grant të Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve, si dhe të dokumentohet me procesverbal të veçantë dhe protokollohet çdo mbledhje e Komisionit sipas standardeve të parashikuara për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.

Afati: Në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi:

Me Urdhrin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Nr. 4, (nr. 2841 prot), datë 16.05.2022 “Për emërimin e menaxherit të skemës së granteve dhe masave mbështetëse”, është caktuar si menaxhere e grantit Znj. M.M, me pozicionin Këshilltar i Ministrit dhe me Urdhrin nr. 5 prot 2842, datë 16.05.2022 “Për ngritjen e strukturës përgjegjëse për shërbimin One-Stop-Shop” janë caktuar Znj. P.S, Sekretariati Teknik i KEK dhe Znj. K.Gj, Sekretariati Teknik i KEK. Emërimi i një funksionari politik në krye të funksionit administrativ të menaxhimit të grantit, (detyrat e të cilit janë të përcaktuara në rregulloren e grantit si zbatimi dhe menaxhimi i grantit), bie në kundërshtim me Ligjin 90/ 2012 “Për funksionimin e administratës shtetërore”, Neni 17 “Kabinetet”, pika 1, si dhe Kreu III, “Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore”, Seksioni 1 “Ministritë”, Neni 11. Duke u nisur nga fakti që në strukturën e MiSHMS ka vetëm *funksionarë politikë*, menaxhimi i grantit nga njësia aktuale e menaxhimit të grantit (në krye të të cilës qëndron menaxheri i grantit), sjell një problematikë në vetvete, duke qenë kjo njësi, përgjegjëse për funksione administrative si certifikimi i shpenzimeve reale të kryera nga aplikantët fitues gjatë fazave të planifikuara të lëvrimit të kësteve. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me Ligjin 90/ 2012, datë 27.9.2012 “Për funksionimin e administratës shtetërore”,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Neni 17 “Kabinetet”, pika 1, si dhe Kreu III, “Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore”, Seksioni 1 “Ministritë”, Neni 11.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 3, faqe 31-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi:

MiSHMS të marrë masa që në përmbushjen e detyrës së menaxhimit të grantit të emërojë punonjës me funksione administrative konform dispozitave ligjore në fuqi.

Afati: Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi:

Gjatë auditimit të regjistrimit të startup-eve dhe krahasimit të të dhënave me pasaportën e startup-it u konstatua se janë dhënë 967 pasaporta startup-i, 48 prej të cilave rezultojnë të kenë ose të njëjtin emër tregtar, ose të njëjtin numër regjistrimi (NUIS) në regjistrin tregtar ndërkohë që 1 prej tyre është i pajisur me pasaportë lehtësuesi. Kështu, u konstatuan se janë pajisur me nga 2 pasaporta të ndryshme 22 startup-e duke patur të njëjtin emër tregtar, si dhe 15 startup-e me të njëjtin numër në regjistrin tregtar. Nga auditimi i regjistrimit të lehtësuesve të startup-eve konstatohet se nga 238 lehtësues, janë pajisur me pasaporta të ndryshme lehtësuesi, 5 aplikantë me të njëjtin numër identifikimi në regjistrin tregtar. Pajisja e startup-eve dhe lehtësuesve me të njëjtin numër identifikimi në regjistrin tregtar me pasaporta të ndryshme merr rëndësi për faktin e pamundësisë së marrjes pjesë së tyre tek e njëjta thirrje sipas përcaktimeve në rregulloren e grantit, si dhe në shtimin e numrit të përgjithshëm të startup-eve dhe lehtësuesve duke cenuar saktësinë e regjistrimit.

10.1. MiSHMS nuk përdor aktualisht një manual të brendshëm për organizimin dhe funksionimin e këtij regjistri. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me Ligjin nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, Neni 5, “Administrimi i bazës së të dhënave shtetërore”, si dhe VKM nr. 312, datë 11.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për përmbajtjen e regjistrimit të startup-eve dhe lehtësuesve, mënyrën e funksionimit dhe ndërlidhjen e tij me portalin qeveritar “e-albania”, si dhe për dokumentet elektronike pasaporta e startup-eve dhe pasaporta e lehtësuesve”, Kreu V.

10.2. Nga auditimi i regjistrimit të startup-eve dhe lehtësuesve konstatohet se ky dokument është mbajtur vetëm në mënyrë elektronike; nuk i përmban të gjitha të dhënat parësore; nuk i përmban kryesisht të gjitha të dhënat dytësore, të parashikuara në VKM nr. 312, datë 11.05.2022 “Përcaktimin e rregullave të hollësishme për përmbajtjen e regjistrimit të startup-eve dhe lehtësuesve, mënyrën e funksionimit dhe ndërlidhjen e tij me portalin qeveritar “e-albania” si dhe për dokumentet elektronike – pasaporta e startup-eve dhe pasaporta e lehtësuesve, pika 1 dhe 2, a) iv, v, vii dhe b), të cilat duhet të përmbajnë të dhënat e numrit të pjesëtarëve të startup-it, fushën ku operon, përshkrimi i startup-it, datën e regjistrimit në regjistrin tregtar, selinë, kontaktet, etj.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 3, faqe .31-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi:

MiSHMS të marrë masa për përmirësimin e regjistrimit të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve me fokus si më poshtë:

- a) Në eliminimin e dublikimeve të pasaportave të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve;
- b) Në plotësimin me të dhënat parësore dhe dytësore të çdo mbajtësi të pasaportës;
- c) Në hartimin dhe vënien në përdorim të një manuali mbi organizimin dhe funksionimin e këtij regjistri;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUCIONIN E MINISTRIT TË
SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

- d) Në hartimin e një dokumenti hardcopy të regjistrit të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve në funksion të ruajtjes të formës së pandryshuar konform vitit të cilit i përkon.

Afati: Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTE I SHTETIT